

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXIV, nr. 7806  
E premte, 7 qershor 2024  
Çmimi 0.50

## Hapet Panairi i 24-të i Librit në Prishtinë



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)



facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

**AWR** **ABBRUCH** GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

### AKTUALE



**BIDENI DHE LIDERËT EVROPIANË I BËJNË THIRRJE HAMASIT TA PRANOJË MARRËVESHJEN E ARMËPUSHIMIT** F. 2

**MICKOSKI MANDATOHET PËR KRYEMINISTËR TË MAQEDONISË SË VERIUT** F. 5

**PK-JA NË PRISHTINË: 15 HEKTARË TË PRONËS KOMUNALE TE STACIONI I AUTOBUSËVE U TJETËRSUAN PËR NDËRTIM** F. 7

### EKONOMI



**KOSOVA MERR UDHËHEQJEN E PRESIDENCËS SË ECB-së** F. 8

**MURATI: ASNJË AKSIDENT ME FATALITET NË VENDIN E PUNËS NË GJASHTËMUJORIN E PARË** F. 8

### SPORT



**SYLVINHO PARA MIQËSORES NDAJ AZERBAJXHANIT: DO TË BËJ NDRYSHIME NË FORMACION** F. 10

## KONJUFCA: BE-ja S'MUND TË NA MARRË KOMPETENCËN PËR PROPOZIMIN E DRAFTIT TË ASOCIACIONIT

FAQE 4-5



"Drafti që është dorëzuar nga ana e Bashkimit Evropian ka një parregullsi, sepse kjo nuk është kompetencë e BE-së dhe

mendoj se, nëse BE-ja nuk e modifikon këtë qëndrim, atëherë po i bie që do t'ia marrë me zor një kompetencë shtetit

të Kosovës", ka deklaruar të enjten para gazetarëve kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca

**OSMANI THOTË SE DALLIMET ME KURTIN JANË TË TEJKALUESHME** F. 7



**ZGJEDHJET PËR PARLAMENTIN EVROPIAN: SI ORGANIZOHEN DHE KUSH MUND TË VOTOJË?** F. 4



**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepcisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mobi: +377 44 501289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
030 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë.  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) / [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

## Macroni do të marrë pjesë në samitin ukrainas për paqe

PARIS, 6 QERSHOR - Presidenti i Francës, Emmanuel Macron, do të marrë pjesë në një samit ukrainas për paqe, i cili do të mbahet kah mesi i këtij muaji në Zvicër, njoftoi Presidenca franceze të enjten. Zëdhënësi i Zelenskyt, Serhiy Nykyforov, tha se 107 vende dhe organizata ndërkombëtare e kanë konfirmuar pjesëmarrjen në samitin e 15-16 qershorit, në të cilin Ukraina shpreson se do të fitojë mbështetje të gjerë ndërkombëtare për vizionin e saj për kushtet që nevojiten për t'i dhënë fund luftës me Rusinë. Shtëpia e Bardhë njoftoi më 4 qershor se nënpresidentja

amerikane Kamala Harris do ta përfaqësojë ShBA-në në këtë samit. Kievi e mirëpriti këtë njoftim më 5 qershor, edhe pse i kishte bërë thirrje presidenti Joe Biden të merrte pjesë. Rusia nuk është ftuar në samitin e organizuar nga Ukraina. Moska e ka hedhur poshtë rëndësinë e këtij samiti në Zvicër, duke thënë se bisedimet për paqe pa Rusinë "nuk kanë kuptim". Qeveria zvicerane është nikoqire e ngjarjes me kërkesën e Ukrainës. Rusia e nisi pushtimin e Ukrainës në shkurt 2022.



## Bideni dhe liderët evropianë i bëjnë thirrje Hamasit ta pranojë marrëveshjen e armëpushimit

WASHINGTON, 6 QERSHOR - Presidenti i Shteteve të Bashkuara, Joe Biden dhe gjashtëmbëdhjetë liderë të tjerë botërorë kërkuar të enjten nga Hamasi - grupi palestinez i shpallur organizatë terroriste nga ShBA-ja dhe fuqi të tjera - që të pranojë një marrëveshje armëpushimi dhe nga Izraeli që të pranojë kompromise. "Nuk ka kohë për të humbur. Ne i bëjmë thirrje Hamasit të mbyllë këtë marrëveshje", thuhet në deklaratën e lëshuar nga Shtëpia e Bardhë.

Deklarata u nënshkrua nga krerët e fuqive kryesore evropiane, Britanisë, Francës dhe Gjermanisë, si dhe nga Spanja, e cila së fundmi e ka njohur shtetin palestinez. Kjo deklaratë mbledhi edhe liderët e Brazilit dhe Kolumbisë. Deklarata e së enjtes u nënshkrua



gjithashtu nga Tajlanda, e cila ka një fuqi të madhe punëtorësh në Izrael. Vende të tjera që nënshkruan deklaratën ishin Austria, Bullgaria, Kanadaja, Danimarka, Polonia, Portugalia, Rumania dhe Serbia. Shtetet e Bashkuara kanë thënë

vazhdimisht se i takon Hamasit të pranojë marrëveshjen, por deklarata gjithashtu bëri thirrje për fleksibilitet nga Izraeli. "Në këtë moment vendimtar, ne u bëjmë thirrje udhëheqësve të Izraelit si dhe Hamasit që të bëjnë çfarëdo kompromisi përfundimtar të


nevojshëm për të mbyllur këtë marrëveshje dhe për të sjellë lehtësim për familjet e pengjeve, për ata në të dyja anët e këtij konflikti të tmerrshëm, përfshirë civilët", thuhet në deklaratë. "Është koha që lufta të përfundojë dhe kjo marrëveshje është pika e nevojshme fillestare". Ditë më parë, Bideni e shpalsi një propozim trefazësh të Izraelit për përfundimin e konfliktit në Rripin e Gazës, duke thënë se "ka ardhur koha që kjo luftë të marrë fund". Faza e parë përfshin një armëpushim gjashtë-javor, gjatë të cilit forcat izraelite do të tërhiqeshin nga "të gjitha zonat e banuara" të Gazës, disa pengje të moshuar dhe gra - do të liroheshin në këmbim të lirisë të qindra të burgosurve palestinezë; civilët palestinezë do të ktheheshin në shtëpitë e tyre në Gazë; dhe 600

kamionë në ditë do të dërgonin ndihmë humanitare në enklavën e rrënuar. Në fazën e dytë, Bideni tha se do të shkëmbeheshin të gjitha pengjet e gjalla, përfshirë ushtarë; forcat izraelite do të tërhiqeshin nga Gaza dhe armëpushimi i përhershëm do të niste. Faza e tretë parasheh një plan të madh rindërtimi për Gazën, si dhe rikthimin e "mbetjeve të fundit" të pengjeve të familjet e tyre. Hamasi e sulmoi Izraelin më 7 tetor të vitit të kaluar, duke vrarë mbi 1 200 njerëz dhe duke marrë peng rreth 250 të tjerë. Pas këtij sulmi, nisi lufta në Rripin e Gazës - të kontrolluar nga Hamasi. Dhjetëra pengje të marra prej këtij grupi, u liruan gjatë një armëpushimi në nëntor, ndërsa disa të tjera u gjetën - të vdekur ose të gjalla - nga trupat izraelite.

## Katër të vdekur dhe mbi 20 të lënduar në një përplasje mes trenave në Çeki

Pragë, 6 qershor - Katër persona humbën jetën, në mesin e tyre dy ukrainas dhe më shumë se 20 të tjerë u lënduan pasi një tren pasagjerësh u përplas me një tren mallrash në Republikën Çeke, njoftuan autoritetet të enjten. Ministri i Brendshëm, Vit Rakushan, tha se përplasja ndodhi të mërkurën në mbrëmje pas orës 23:00, përgjatë korridorit kryesor hekurudhor nga Praga drejt lindjes. Treni i udhëtarëve me shpejtësi të lartë i përkiste kompanisë private Regiojet. Rakushan tha se asnjë nga të plagosurit nuk ishte në rrezik për jetë. Operatori i trenit të pasagjerëve tha më vonë se 380 pasagjerë

ishin në trenin i cili ishte rrugës për në qytetin sllovak Koshice. Një pjesë e trenit më pas do të nisej për në qytezën Chop, në Ukrainë. "Sipas informacioneve paraprake, katër persona humbën jetën. Mes tyre janë dy shtetas të Ukrainës. Shtetësia e të tjerëve që humbën jetën po sqarohet", thuhet në deklaratën e ministrit. Ministri i Transportit, Martin Kupka tha se rruga kryesore midis Pragës dhe pjesës lindore të vendit duhej të mbyllej ndërsa autoritetet hetonin përplasjen. "Ne nuk mund dhe nuk do të spekulojmë për shkakun e aksidentit", tha Kupka. Policia tha më vonë se po hetonte një neglizhencë të mundshme.



Një postim i policisë çeke në llogarinë e saj në rrjetet sociale tregonte një kolonë automjete të shërbimit të urgjencës dhe një helikopter.

Kompania shtetërore e trenave, Hekurudhat Çeke tha se binarët mund të qëndrojnë të mbyllur për gjithë ditën "për shkak të shkallës së aksidentit".

Ajo këshilloi pasagjerët që të shmangin përdorimin e itinerarit gjatë gjithë ditës. Zjarrfikësit arritën të zbulojnë identitetin e të gjithë pasagjerëve dhe sipas tyre askush nuk mungonte. Drejtuesit e të dy motorëve mbijetuan, tha agjencia çeke e lajmeve. Pas aksidentit, shtatëmbëdhjetë persona u pranuan në departamentin e urgjencës të spitalit Pardubice. Kryeministri Petr Fiala e quajti aksidentin një tragjedi të madhe dhe shprehu ngushëllimet e tij për familjet e të vdekurve. Ndërkaq pronari i Regio Jet tha se kompania e tij ishte gati të kompensonte pasagjerët.

# Konjufca: BE-ja s'mund të na marrë kompetencën për propozimin e draftit të Asociacionit

“Drafti që është dorëzuar nga ana e Bashkimi Evropian ka një parregullsi, sepse kjo nuk është kompetencë e BE-së dhe mendoj se, nëse BE-ja nuk e modifikon këtë qëndrim, atëherë po i bie që do t'ia marrë me zor një kompetencë shtetit të Kosovës”, ka deklaruar të enjten para gazetarëve kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca



draft, i cili do të jetë draft zyrtar, dhe që pastaj kalon në Gjykatë Kushtetuese e në instanca të tjera”, tha Konjufca.

Kosova dështoi të futej në agjendën e takimit të Komitetit të Ministrave në Këshillin e Evropës, i mbajtur në mes të majit në Strasburg, pasi shtetit iu vendos kusht që të lëvizte përpara me themelimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe.

Një ditë para takimit në Strasburg, kryediplomatja e Kosovës, Donika Gërvalla, përmes një letre njoftoi Këshillin e Evropës se Kosova synon të hartojë një draft-statut për Asociacionin dhe ta dërgojë në Kushtetuese deri në fund të vitit, në këmbim të pranimit të shtetit në këtë organizatë për të drejtat e njeriut. Por, në letrën e Gërvallës thuhet se draft-statuti do të frymëzohet nga një draft i paraqitur kohë më parë nga organizata gjermane Friedrich-Ebert-Stiftung, e jo draft-statuti që iu paraqit Kosovës dhe Serbisë nga BE-ja tetorin e vitit të kaluar. Megjithatë, Kosova deri më tani nuk ka ndërmarrë hapa drejt themelimit të tij.

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 6 QERSHOR - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, ka thënë se nuk është kompetencë e Bashkimit Evropian që të propozojë draft-statut për Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe në Kosovë. “Drafti që është dorëzuar nga ana e Bashkimit Evropian, ka një parregullsi, sepse kjo nuk është kompetencë e BE-së dhe mendoj se, nëse BE-ja nuk e modifikon këtë qëndrim, atëherë po i bie që do t'ia marrë me zor një kompetencë shtetit të Kosovës”, ka deklaruar Konjufca të enjten para gazetarëve. Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë të mërkurën, në një intervistë për A2CNN, se

emisari i BE-së për dialogun Kosovë - Serbi, Miroslav Lajčak, mund ta dërgojë draftin në Komisionin e Venedikut.

Draftin e BE-së, Kurti e ka cilësuar “non-paper”. “Është një ide [dërgimi i draftit nga Lajčak në Komisionin e Venedikut] të cilën edhe unë si kryetar i Kuvendit e mbështes”, është shprehur Konjufca. Sipas tij, çështja e Asociacionit nuk mund të marrë epilog “për shkak të mënyrës se si është shtruar nga bashkësia ndërkombëtare”.

Vitin e kaluar Bashkimi Evropian, si ndërmjetës i dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë, ua paraqiti palëve një draft-statut për Asociacionin, i cili u pranua në parim. Në të njëjtin vit, Kosova dhe Serbia arritën një marrëveshje për normalizimin e

raporteve, që parasheh edhe sigurimin e një niveli të vetëmenaxhimit të komunitetit serb dhe zbatimin e të gjitha marrëveshjeve të arritura në dialog.

Në kuadër të dialogut që ndërmjetësohet nga BE-ja, Kosova dhe Serbia kanë arritur dy marrëveshje për Asociacionin: më 2013 dhe 2015. Më 2015 Gjykata Kushtetuese tha se Marrëveshja mbi parimet për themelimin e Asociacionit nuk ishte në harmoni të plotë me

aktin më të lartë juridik të shtetit. Harmonizimi, sipas Kushtetueses, mund të bëhet përmes akteve nënligjore. “Nuk mendoj se Kosova ka të drejtë të penalizohet se është vonuar [për draftin e Asociacionit], penalizimet mund të jenë të tjera, penalizim kanë qenë sanksionet, edhe atë e kemi vuajtur ne si Kosovë, çmimet kanë qenë dhe çmimet i ka paguar Kosova. Por, kompetencën nuk mund të na marrë BE-ja për ta propozuar një

## Osmani thotë se dallimet me Kurtin janë të tejkalueshme

SHKUP, 6 QERSHOR - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka thënë një ditë më parë se dallimet mes krerëve shtetërorë janë të tejkalueshme kur interesi shtetëror dhe qytetar vihet mbi të gjitha, duke thënë se nuk ka luftë politike me qeverinë e kryeministrit Albin Kurti.

Në javët e fundit u raportua për “prishjen” e mundshme të raporteve në mes të Osmanit dhe Kurtit, pasi presidentja kishte thënë se qeveria nuk ishte konsultuar me të, lidhur me hapat që ka bërë Kosova për anëtarësim në Këshill të Evropës në maj.

Kurti i hodhi poshtë këto pretendime të martën, duke thënë nuk beson që ekzistojnë dallime të patejkalueshme mes tij dhe Osmanit.

E pyetur të mërkurën pas një takimi me kryetarët e komunave rreth deklaratës së Kurtit,



Osmani tha se “natyrisht që kur vendoset interesi shtetëror dhe interesi qytetar mbi të gjitha, çdo dallim është i tejkalueshëm”. Ajo tha se tani është “e

domosdoshme” që të gjitha institucionet dhe të gjitha partitë politike të ulen dhe të “reflektojmë për temat e interesit nacional”. “Për mua

temat e interesit nacional nuk janë detaje të parëndësishme, janë tema që kërkojnë kontributin e secilit prej nesh. Kur ulemi së bashku e vendosim, atëherë domosdoshmërisht rezultati do të jetë i mirë, siç ka dëshmuar historia për këto 25 vjet”, tha presidentja.

Osmani tha në maj se nuk u konsultua për letrën që ministrja e Punëve të Jashtme e Kosovës, Donika Gërvalla, ia kishte dërguar presidentit të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës, Theodoros Rousopoulos, më 16 maj.

Bërja e hapave drejt Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe ka qenë kusht për Kosovën për anëtarësim në këtë organizatë lidere në fushën e të drejtave të njeriut në muajin maj.

Një ditë para mbledhjes së Komitetit të Ministrave të

Këshillit të Evropës, autoritetet e Kosovës patën thënë se gjatë muajit maj do të dërgonin për shqyrtim në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës një propozim për formim të Asociacionit, mirëpo zyrtarë të lartë të Perëndimit kanë vlerësuar se diçka e tillë ka qenë e pamjaftueshme për ta plotësuar kushtin.

Lista Guxo, e cila është themeluar nga presidentja Osmani, së bashku me ministrën Gërvalla, pati garuar në një listë të përbashkët me Lëvizjen Vetëvendosje në zgjedhjet e vitit 2021.

Guxo, së bashku me Lëvizjen Vetëvendosje, patën fituar mbi 50 për qind të votave.

Qeveria e re, në krye me Kurtin, u formua më 22 mars të vitit 2021. Osmani u zgjodh presidente pak ditë më vonë, më 4 prill 2021.

## Ndërron jetë akademik Rexhep Ferri

Prishtinë, 6 qershor - Të enjten në moshën 86-vjeçare ka ndërruar jetë një ndër piktorët më të mëdhenj të artit shqiptar, akademik Rexhep Ferri.

Akademia e Shkencës dhe Arteve e Kosovës u ka shprehur ngushëllime familjes, miqve dhe gjithë artdashësve. Akademik Ferri i përket

gjeneratës së artë të piktorëve kosovarë.

Rexhep Ferri lindi në Kukës më 1937. Në vitin 1958 mbaroi Shkollën e Mesme të Artit në Pejë, ndërsa në vitin 1966 u diplomua në Degën e Pikturës të Akademisë së Arteve në Beograd.

Në respekt të jetës dhe veprës

së akademik Rexhep Ferrit, në Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës më 7 qershor, në orën 11:00, mbahet mbledhja përkujtimore dhe më pas, deri në orën 12:00, bëhen homazhe. Varrimi i të ndjerit do të bëhet të premten në orën 13:00 në varrezat e Prishtinës.





# Zgjedhjet për Parlamentin Evropian: Si organizohen dhe kush mund të votojë?

**BRUKSEL, 6 QERSHOR** - Rreth 373 milionë shtetas të 27 vendeve anëtare të Bashkimit Evropian do të mund të votojnë në zgjedhjet për Parlamentin Evropian që do të mbahen më 6-9 qershor.

Parlamenti Evropian është trupi i vetëm i Bashkimit Evropian që përfaqëson shtetasit e vendeve anëtare. Funksioni i tij primar përfshin negociimin e ligjeve të BE-së me anëtarë të qeverive, që përfaqësohen prej Këshillit Evropian.

Parlamenti Evropian, po ashtu, miraton buxhetin e BE-së dhe voton për marrëveshjet ndërkombëtare, si dhe për zgjerimin e bllokut evropian.

Ky institucion ka përgjegjësi mbikëqyrëse, përfshirë fuqinë për të miratuar apo refuzuar emërimin e presidentit të Komisionit Evropian - pozitë në të cilën është aktualisht Ursula von der Leyen e Gjermanisë - dhe të komisionarëve.

Për dallim prej parlamenteve kombëtare, Parlamenti Evropian nuk ka të drejtë të propozojë ligje, por mund t'i negociojë ligjet e propozuara prej Komisionit Evropian. Parlamenti Evropian përbëhet prej 720 anëtarëve dhe zgjedhjet të mbahen çdo pesë vjet. Deputetët e këtij institucioni

e zgjedhin më pas presidentin për një mandat dy vjet e gjysmë. Presidentja aktuale në shkuarje është Roberta Metsola e Italisë.

## Kush mund të votojë?

Në 21 vende anëtare mund të votojnë shtetasit mbi moshën 18-vjeçare.

Në Belgjikë, Gjermani, Austri dhe Maltë, moshja minimale është 16-vjeçare.

Shtetasit e Greqisë, që kanë mbushur 17 vjet në vitin zgjedhor, do të mund të votojnë, po ashtu, ndërsa në Hungari, individët e martuar mund të votojnë pavarësisht moshës.

Shtetasit e BE-së mund të votojnë në shtetin e tyre të origjinës, apo edhe prej jashtë. Votimi prej jashtë është i lejuar në të gjitha vendet anëtare, përveç në Çekë, Irlandë, Maltë dhe Sllovaki.

Në Bullgari dhe Itali, kjo e drejtë u takon vetëm atyre që jetojnë brenda bllokut evropian.

Shtetasit që jetojnë në ndonjë vend tjetër të BE-së mund të zgjedhin për të votuar prej shtetit të origjinës, apo për kandidatët e shtetit ku jetojnë.

Votuesit mund të zgjedhin se për cilin kandidat të cilit vend do të votojnë, mirëpo nuk u lejohet që

të votojnë në dy shtete në të njëjtën kohë.

## Si votohet?

Në disa vende anëtare, votuesit do të mund të zgjedhin një kandidat prej listave të ngushta - pra nuk lejohet ndryshimi i rendit të kandidatëve të preferuar - ndërsa në disa vende tjera, ata mund të zgjedhin kandidatët individualisht, përmes një sistemi preferencial. Varësisht prej ligjeve kombëtare, disa votues mund ta shfrytëzojnë të drejtën e tyre në ambasadat kombëtare, përmes postës, apo në mënyrë elektronike.

## Kush mund të garojë si kandidat?

Votuesit mund të zgjedhin kandidatët individualë apo delegatë të partive politike, varësisht prej shtetit.

Pasi të zgjidhen, politikanët prej secilit vend mblidhen nëpër grupe evropiane, varësisht prej orientimeve politike, për të formuar Parlamentin.

Disa vende anëtare, përfshirë Gjermaninë, përcaktojnë që për zgjedhjet e Parlamentit Evropian

mund të nominohen vetëm pjesëtarë të partive politike apo figura të lidhura me politikën. Individët e zgjedhur nuk mund të mbajnë pozita në qeveritë kombëtare apo trupa tjera politike, sikurse Komisioni Evropian, Gjykata e Drejtësisë apo Gjykata e Audituesve. Mbi të gjitha, të gjithë kandidatët duhet të jenë shtetas të BE-së.

## Parashikimet për zgjedhjet e vitit 2024

Gjashtë prej 10 shtetasve të BE-së kanë shprehur interesim për të votuar në këto zgjedhje, ka treguar një sondazh i kryer prej Agjencisë së Statistikave të BE-së, Eurostat, në prill.

Parashikimet e sondazhit tjetër Europe Elects tregojnë që prej 720 ulëseve në Parlamentin Evropian, grupi i Partisë Popullore Evropiane që i përket qendrës së djathtë do t'i fitojë 180 ulëse, Aleanca Progresive e Socialistëve dhe Demokratëve që i takon qendrës së majtë pritet të fitojë 138 ulëse, ndërsa Rinovoni Evropën, parti liberale e qendrës, pritet të fitojë 86 ulëse.

Konservatorët dhe Reformistët Evropianë pritet të fitojnë 75 ulëse, ndërsa Identiteti dhe

Demokracia pritet të fitojë 68 ulëse.

Partitë tjera më të vogla pritet të fitojnë së bashku 173 ulëse, sipas sondazhit.

## Rezultatet e zgjedhjeve të vitit 2019

Në zgjedhjet e kaluara ka ndodhur një ndryshim i madh në forcat partiake, pasi partitë e qendrës së djathtë dhe ato të qendrës së majtë kanë humbur një pjesë të votave kundrejt partive më të vogla.

Partia Popullore Evropiane dhe Aleanca Progresive e Socialistëve dhe Demokratëve kanë humbur 76 ulëse së bashku.

Kjo nënkupton se ato kanë humbur shumicën, që e kanë gëzuar për kohë të gjatë.

Diçka e tillë ka rezultuar me krijim të koalicioneve me grupet partiake të qendrës dhe ato pro BE-së, sikurse Rinovimi i Evropës dhe Të Gjelbrit.

Dalja në votime atë vit pati arritur në 50.66 për qind - shifrën më të madhe në 20 vjet çka përbën rritje prej 8 për qind prej vitit 2014.

Një realitet i tillë tregon për një rritje të interesit publik në çështjet si ndryshimet klimatike, migrimi dhe pabarazia ekonomike. (REL)

## Haradinaj, Kurtit: Rriti pagat e kategorive të lirisë

Prishtinë, 6 qershor - Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, ka thënë se kategoritë e lirisë përgjatë këtij mandati qeverisës janë poshtëruar vazhdimisht. Ish-kryeministri Haradinaj ka shkruar në "Facebook" se Vetëvendosje kur është bërë fjalë për veteranët e UÇK-së, i ka bashkuar votat me Listën

Serbe. "Katër vjet pushtet të Kurtit, e kategoritë e lirisë vazhdimisht janë poshtëruar nga qeveria. Vetëvendosje nuk ka hezitur që për të mos i përfshirë kategoritë e lirisë në pagën minimale, t'i bashkojë votat edhe me Listën Serbe. Nëse Kurti pretendon që vartësit e tij 'ia kanë pirë duhanin tinëz', atëherë le t'i rrisë sot

pagat e familjeve të dëshmorëve e martirëve, invalidëve, veteranëve, viktimave të dhunës seksuale. Mundësinë dhe buxhetin e mjaftueshëm e ka. Fatkeqësisht, kjo nuk pritet të ndodhë, sepse është vetë Kurti ai që qëndron pas marrëveshjeve me 'vendasin' dhe Listën Serbe", ka shkruar Haradinaj.



# Mickoski mandatohet për kryeministër të Maqedonisë së Veriut



**SHKUP, 6 QERSHOR** - Presidentja e Maqedonisë së Veriut, Gordana Silanovska-Davkova, të enjten, më 6 qershor, ia ka dhënë mandatin për formimin e qeverisë, kryetarit të VMRO DPMNE-së, Hristijan Mickoski. "Besoj se hapin që po e bëj sot, duke ia besuar formimin e qeverisë z. Hristijan Mickoski, është hapi i vërtetë juridik dhe politik", ka thënë Davkova. Sipas Kushtetutës, mandati për formimin e qeverisë i jepet partisë e cila në zgjedhje fiton numrin më të madh të

deputetëve dhe që arrin të sigurojë mbi 60 vota për votimin e saj në Kuvend. Në zgjedhjet parlamentare të 8 majit, VMRO DPMNE-ja ka fituar 58 ulëse në Kuvendin e Maqedonisë së Veriut. Pas marrjes së mandatit, kryetari i VMRO DPMNE-së, Hristijan Mickoski, ka afat prej 20 ditësh për paraqitjen në Kuvend të përbërjes së re të qeverisë dhe programit të punës. Mickoski ka thënë se dorëzimin e listës me emrat

për përbërjen e qeverisë së re do ta bëjë në afatin e parë të mundshëm. "Pres që ta dorëzoj përbërjen sa më shpejt të jetë e mundur, apo para festave fetare që vijnë - Kurban Bajrami (16 qershor) dhe Dita e Shpirtrave (21 qershor)", ka thënë Mickoski. Qeveria e re do të formohet nga VMRO DPMNE-ja, koalicioni shqiptar VLEN dhe lëvizja ZNAM. Këto tri parti së bashku do të kenë 78 deputetë. Para votimit të qeverisë, Kuvendi duhet të miratojë një

ligj për riorganizimin e ministrive, megjithatë, për këtë nevojitet shumica prej dy të tretash (apo 80 vota) në Kuvendin prej 120 anëtarësh. Mickoski të mërkurën i ka dorëzuar propozim-amendamentet në Kuvend, por ndonëse nuk ka dashur të konfirmojë drejtpërdrejt se a ka siguruar mbështetjen e 80 deputetëve, ka thënë se ata nuk janë "fillestarë në politikë" për të "besuar në rastësi". "Ne nuk jemi politikanë naivë që të besojmë në rastësi. Në politikë

rrallëherë ka rastësi", është shprehur Mickoski. Mickoski nuk ka dhënë detaje rreth ndarjes së ministrive apo se kush do t'i drejtojë ato, ndërkohë që përfaqësues të koalicionit VLEN kanë thënë se në qeverinë e re do të kenë një zëvendëskryeministër, gjashtë ministri, dy prej të cilëve do të jenë pa resor, si dhe shtatë zëvendësministra. Nga radhët e koalicionit VLEN është edhe kryetari i Kuvendit, Afrim Gashi, i cili në këtë post u zgjodh më 28 maj.

## Tahiri: Sugjerimi i Kurtit që drafti i Asociacionit të dërgohet në Komisionin e Venecias, amatorizëm

Prishtinë, 6 qershor - Shefi i grupit parlamentar i AAK-së, Besnik Tahiri, e ka quajtur amatorizëm sugjerimin e kryeministrit, Albin Kurti, që drafti i Asociacionit të dërgohet në Komisionin e Venecias. Tahiri i ka bërë me dije Kurtit se asnjë palë e tretë

nuk mund dhe nuk ka mandat të dërgojë atje akte për shqyrtim. "Kryeministri Kurti në kërkim të një rrugëdalje nga qorrsoaku ku ka hyrë vetë dhe ku e ka futur Kosovën me temën e draftit të Asociacionit, me pasoja lënien e vendit në paradhomë të pritjes për

anëtarësim në KiE, po kërkon që BE dhe Lajçak të shërbejnë si zëdhënës të qeverisë së tij, duke sugjeruar që ata mund ta çojnë draftin në Komisionin e Venecias. Ky është amatorizëm dhe mashtrim klasik", ka shkruar në "Facebook".



## Përkujtohen dëshmorët Hasan dhe Xhavit Hasani nga Pokleku i Vjetër

DRENAS, 6 QERSHOR - Në përvjetorin e rënies heroike të dëshmorëve Hasan B. Hasani dhe Xhavit B. Hasani nga fshati Poklek i Vjetër,

nënkryetari i komunës së Drenasit, Arben Shala, me bashkëpunëtorë dhe familjarë të dëshmorëve, bënë homazhe duke

vendosur buqeta me lule të freskëta pranë memorialit të dëshmorëve në Marinë. U tha se dëshmorët janë shembuj frymëzimi për të

gjithë ne dhe përkujtohen gjithmonë për guximin, sakrificën dhe devotshmërinë e tyre ndaj atdheut.



## Shënohet 25-vjetori i Ditës së Dëshmorëve të UÇK-së në Mitrovicë

MITROVICË, 6 QERSHOR - Me rastin e shënimit të 25-vjetorit të Ditës së Dëshmorëve të UÇK-së në Mitrovicë, drejtues të komunës së Mitrovicës, familjarë të dëshmorëve, veteranë dhe invalidë të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, si dhe qytetarë të shumtë, kanë bërë homazhe sot në Varrezat e Dëshmorëve në Shipol.

Për ta nderuar luftën e lavdishme të UÇK-së, të gjithë ata që luftuan, në veçanti për ta nderuar sakrificën e dëshmorëve dhe familjeve të tyre, kryetari i komunës, Bedri Hamza, së bashku me nënkryetarin Arian Tahiri, kryesuesen e Kuvendit Komunal, Vesa Broja, drejtorë të drejtorive komunale, kanë bërë homazhe duke vendosur buqeta me lule të freskëta, në varrezat e dëshmorëve në Shipol të



Mitrovicës.

Pjesëmarrës në këto homazhe ishin edhe përfaqësues të institucioneve të tjera lokale, familjarë të dëshmorëve, përfaqësues të organizatave të

dala nga lufta e UÇK-së dhe qytetarë të shumtë.

Në fjalën e tij, kryetari Bedri Hamza tha se jemi mbledhur sot, si në çdo vit tjetër, për ta nderuar veprën dhe figurën e trimave të

kësaj ane në Ditën e Dëshmorëve të Mitrovicës. "Mitrovica i ka dhënë shumë Kosovës në çdo etapë të ekzistencës së saj, por trimëria dhe flijimi i dëshmorëve në luftën e fundit. Është traseja më

e dhimbshme e vendit tonë, në rrugën e gjatë të përpjekjeve, për të realizuar të drejtën e të jetuarit të lirë", është shprehur kryetari Hamza.

Më tutje ai theksoi se kjo liri që po e gëzojmë sot është dhurata më domethënëse e vet ekzistencës tonë, dhuratë kjo që ata e paguan me çmimin më të shtrenjtë - vetë jetën. "Dëshmorët e Mitrovicës, martirët dhe civilët, janë gurthemeli i vet ekzistencës sonë, janë garanci e dhënë me detyrën me të shtrenjtë - flijimin, që ne sot të jetojmë të lirë dhe të pavarur, të punojmë e zhvillohemi. Sot dhe çdo ditë përulemi përpara veprës heroike të Dëshmorëve të Mitrovicës. Lavdi!", tha Hamza. Ky përvjetor u organizua nga komuna e Mitrovicës, përkatësisht në përkujdesjen e kryetarit të komunës.

## Kryetari i Gjilanit: Sisteme ujësjellësi deri në fshatin e fundit

GJILAN, 6 QERSHOR - Nuk kanë të ndalur investimet në sistemin e ujësjellësit të komunës së Gjilanit, përkatësisht në fshatra, e që është fokus edhe këtë vit.

Furnizimi me ujë të pijshëm është nevojë imediate e banorëve të fshatrave, për të cilën edhe po punohet që të ketë sistem deri në fshatin e fundit.

Kryetari Alban Hyseni tregon se po bëhet sistem ujësjellësi për fshatin Uglar me vlerë rreth 333 mijë euro, rezervuar akumulues prej 300 mijë litrash dhe 2 puse me 120 metra thellësi dhe 10058.08 metra gjatësi. "Përveç fshatit Uglar, me sisteme të ujësjellësit janë bërë e po bëhen edhe disa fshatra", tha Hyseni.

I pari i komunës së Gjilanit, tregoi për investimet në Vërbicën e Kmetocit, me vlerë afër 100 000.00 euro.

Investimi në Vrapqic me vlerë 60 169.90 euro, me gjatësi 1575 metra.

Në Pogragjë në vlerë 48 217.04 euro, me gjatësi 735 metra.

Investimet në sistemin e ujësjellësit në Bresalc në vlerë prej 188 000 eurosh, me gjatësi 4 645 metra. Po ashtu, edhe në Cërrnicë ka investime në ujësjellës në vlerë prej 753 000 eurosh, me gjatësi 188 40.48 metra. "Ditë për ditë, fshat për fshat, për sisteme ujësjellësi deri në fshatin e fundit", tha kryetari i Gjilanit, Alban Hyseni.



## Azemi: Punëtorët teknikë në QKUK nga ky muaj me paga të rritura për 100 euro



PRISHTINË, 6 QERSHOR - Kryetari i Sindikatës së Punëtorëve të Sektorit Privat, Jusuf Azemi, ka bërë me dije se nga ky muaj punëtorët teknikë të sektorit privat në QKUK do të marrin pagat me rritje prej 100 eurove.

Azemi në një postim në "Facebook" ka falënderuar ministrin e Shëndetësisë, Arben Vitia, që bëri të mundur këtë rritje. "E filluam me negociata, protesta e

greva me punëtorët teknikë të sektorit privat QKUK dhe, pas shumë përplasjeve, shtyrjeve, këta punëtorë që nga 1 qershori 2024 pagat e tyre do të jenë me rritje për 100 euro më shumë që d.m.th 402 euro", ka shkruar Azemi.

Ai ka shtuar se së shpejti edhe punëtorët e sigurimit fizik do ta kenë po këtë rritje. "Në këtë rritje duhet përmendur edhe ministrin

Arben Vitia i cili me kontributin e tij bëri që 326 punëtorë t'i gëzohen kësaj rritje. Ne dimë edhe të lavdërojmë kur e bëjnë punën mirë ministrat. Së shpejti edhe punëtorët e sigurimit fizik do ta kenë po këtë rritje. Ne pas 6 muajsh do të kërkojmë që edhe kjo pagë të rritet gjithëherë konform ligjeve në fuqi. Kur jemi unikë arrihet gjithçka që lejon ligji", ka shkruar Azemi.

## PDK-ja në Prishtinë: 15 hektarë të pronës komunale te Stacioni i Autobusëve u tjetërsuan për ndërtim

PRISHTINË, 6 QERSHOR - Në një konferencë për medie, nënkryetarja e PDK-së, Besianë Musmurati dhe shefi i grupit të asamblistëve të PDK-së në Prishtinë, Leutrim Retkoceri, treguan për planin e Kalabrisë që u votua të hënën në Prishtinë.

Në këtë plan, 15 hektarë të pronës publike përreth Stacionit të Autobusëve u dhanë për ndërtim të lartë. Planin që e propozoi

Përparim Rama e votoi edhe Lëvizja Vetëvendosje në Prishtinë.

PDK-ja në Prishtinë ishte kundër këtij plani dhe bëri me dije që historia e shpronësimit të Badocit po përsëritet edhe në Kalabri. “Në Badoc, Përparim Rama u mundua ta tjetërsojë pronën publike për t’i akomoduar kërkesat e disa kompanive të ndërtimit të afërta me të. Në planin për lagjen Kalabria, prapë mbi 15

hektarë të pronës publike u vënë në shërbim të kompanive të ndërtimit”, tha Retkoceri.

Ndërsa nënkryetarja e PDK-së, Besianë Musmurati, theksoi që edhe më shqetësues është fakti se Përparim Rama nuk do të ndalet vetëm me planin e Kalabrisë. “Ai do të sjellë për votim plane të tjera që përsëri mund ta tjetërsojnë pronën publike”, tha Musmurati.



## Quinti dhe BE-ja kritikojnë qeverinë për shpronësimin e tokave në veri

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 6 QERSHOR - Ambasadat e Francës, Gjermanisë, Italisë, Mbretërisë së Bashkuar dhe Shteteve të Bashkuara, së bashku me Zyrën e BE-së në Kosovë dhe Misionin e Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë në Kosovë, shprehin keqardhje për vendimin e marrë nga Qeveria e Kosovës më 30 maj që ta finalizojë shpronësimin e mbi 100 parcelave të tokës në komunat me shumicë serbe në veri të Kosovës.

Në deklaratën e tyre të përbashkët thuhet se disa nga misionet e tyre kishin ndarë më herët me qeverinë vlerësimet e ekspertëve ligjorë ndërkombëtarë, duke përfshirë edhe Misionin e Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë, që tregon se qeveria ka shkelur ligjet dhe rregulloret e veta për shkak të mangësive procedurale dhe teknike gjatë procesit të shpronësimit. “Vërejmë se sistemi gjyqësor i Kosovës ka identifikuar shqetësime të ngjashme ligjore me vendimin preliminar të shpronësimit, të cilin qeveria ende nuk e ka adresuar. Përdërisa disa nga pronat e paraqitëse të kërkesës u hoqën nga vendimi përfundimtar i shpronësimit, na vjen keq që Qeveria e Kosovës nuk priti që të gjitha procedurat e hapura gjyqësore të gjykoreshin



plotësisht përpara se të merrte këtë vendim. Është thelbësore që qeveria të bëjë përpjekje për të siguruar që aktivitetet e shpronësimit të jenë në përputhje me ligjin, që të ndiqet procesi i duhur dhe që të drejtat pronësore të pronarëve dhe

titullarëve të të drejtave të respektohen plotësisht. Ndarazi ne i kemi shprehur shqetësimet tona qeverisë se projektligji i shpronësimit nuk është në përputhje me zotimet e Kosovës të marra sipas Planit të Ahtisaarit dhe kemi inkurajuar atë që ta

modifikojë ligjin në përputhje me rrethanat përpara se ta miratojë atë”, është thënë në deklaratën e Quintit, të BE-së dhe të OSBE-së. Ata e kanë inkurajuar Qeverinë e Kosovës t’i përmbahet sundimit të ligjit dhe qeverisjes së mirë, të cilat janë themelet e shoqërive

vitale dhe demokratike. “Për më tepër, ne i bëjmë thirrje qeverisë ta riafirmojë përkushtimin e saj ndaj parimeve të Ahtisaarit, duke përfshirë mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve joshumicë”, thuhet në deklaratën e tyre.


## Policia thotë se në lokacionet e të dyshuarve për spiunazh u konfiskuan armë dhe municione

PRISHTINË, 6 QERSHOR - Policia e Kosovës njoftoi se janë konfiskuar armë, municione dhe maska ushtarake gazi në dy lokacionet e dy shtetasve kosovarë që u arrestuan për spiunazh të mërkurën në Ferizaj.

Prokuroria bëri me dije se dy shtetasit kosovarë u arrestuan pas një hetimi disamujor dhe se i ngarkon ata me veprën penale “spiunazh”. Ata janë ndaluar për 48 orë me vendim të prokurorit. “Gjatë kontrollit në lokacionin e dy të

dyshuarve kosovarë, në cilësi të provave materiale janë gjetur dhe sekuestruar dokumente të ndryshme, kompjuterë, telefona, USB, DVR, kaseta, armë dhe municione, maska ushtarake gazi, si dhe shumë dëshmi të tjera”, thuhet në raportin 24-orësh të Policisë së Kosovës.

Lidhur me këtë rast nuk janë dhënë më shumë detaje. Por, mediet lokale raportuan se personat e arrestuar dyshohet se kanë spiunuar për Agjencinë Serbe të



Sigurisë dhe Informacionit (BIA).

Në një reagim më vonë të mërkurën, BIA tha se e mohon “çdo lidhje me personat e arrestuar në Kosovë”.

BIA shtoi se bëhet fjalë për “përpjekjet e Prishtinës për përhapjen e lajmeve të rreme, se janë dy persona me initiale B. Sh. dhe M. Q., të cilët janë arrestuar të mërkurën në Ferizaj me akuzën se kanë kryer veprën penale të spiunazhit në marrëdhënie bashkëpunimi me Agjencinë”.

## Murati: Asnjë aksident me fatalitet në vendin e punës në gjashtëmuajorin e parë

PRISHTINË, 6 QERSHOR - Ministri i Financave, Hekuran Murati, ka njoftuar se në gjashtëmuajorin e parë të këtij viti nuk është shënuar asnjë aksident me fatalitet në vendin e punës.

Murati ka uruar që ky trend të vazhdojë deri në fund të vitit e të bëhet normë e re edhe për vitet e ardhshme. "Inspektorati i Punës do të vazhdojë kontrollet me intensitet të shtuar, sidomos

në sektorët që përbëjnë rrezikshmëri të lartë. Kemi dyfishuar numrin e inspektorëve të punës dhe numri do të rritet edhe më tutje sivjet. Gjithashtu, janë shtuar ndjeshëm edhe kampanjat e përqendruara të inspektimeve, siç e kishim në tremujorin e parë të këtij viti, në bashkëpunim edhe me ATK-në", ka shkruar Murati në "Facebook".

Ministri Murati ka shtuar se

në mënyrë që ky trend i jashtëzakonshëm të vazhdojë, "lusim të gjithë punëtorët që të kenë kujdes gjatë punës". "Njëkohësisht u bëjmë thirrje edhe punëdhënësve që të sigurohen se i përmbushin kushtet për të ofruar ambiente të sigurta pune dhe pajisje përkatëse që parandalojnë lëndimet në vendin e punës. Bashkërisht, le ta mbajmë këtë statistikë zero", ka shkruar Murati.



## Kosova merr udhëheqjen e Presidencës së ECRB-së

PRISHTINË, 6 QERSHOR - Zyra e Rregullatorit për Energji ka njoftuar se Kosova për herë të parë pas nënshkrimit të Traktatit të Athinës në vitin 2005 merr udhëheqjen e Presidencës së ECRB. "Bordi Rregullativ i Komunitetit të Energjisë (ECRB), pas dështimit në përzgjedhjen e Presidentit në dy takimet e rregullta, në takimin e tij të jashtëzakonshëm të mbajtur më 05.06.2024 në Athinë, pas disa raundesh votimi, ka zgjedhur kryesuesin e Zyrës së Rregullatorit për Energji, z. Ymer Fejzullahu, si Presidentin e ri të ECRB-së", ka njoftuar Zyra e Rregullatorit për Energji.

ECRB është organi i pavarur rajonal i rregullatorëve të energjisë në Komunitetin e Energjisë dhe

drejtohet nga bordi i përfaqësuesve të nivelit të lartë nga agjencitë kombëtare rregullatore të energjisë të palëve kontraktuese, vëzhguesve dhe pjesëmarrësve të Komunitetit të Energjisë.

Mandati i Fejzullahut si president i ECRB-së është në kohëzgjatje prej dy vitesh. Presidenti i ECRB-së ka një rol unifikues dhe vepron për të siguruar që të gjithë anëtarët dhe pjesëmarrësit e ECRB-së të punojnë me një qëllim të përbashkët për t'i përmbushur rolet e tyre sipas Traktatit të Komunitetit të Energjisë.

Në fjalën e tij me rastin e pranimit të detyrës se re, Fejzullahu falënderoi të gjithë për besimin e dhënë me rastin e përzgjedhjes si president i ECRB-së. "Është nder



dhe privilegj për mua, njëkohësisht është edhe përgjegjësi jashtëzakonisht e madhe udhëheqja e ECRB-së. Shkëmbimi i njohurive dhe përvojave rregullative është theksuar si asnjëherë më parë në vitet e fundit kur të gjitha shtetet tona kanë kaluar një krizë të paprecedentë energjetike, por me përvojën që kemi ndarë me njëri-tjetrin ia kemi dalë mbanë të tejkalojmë këtë krizë me pasoja minimale. Tani para nesh, ndër të tjera, kemi transpozimin e paketës së fundit të Direktivave Evropiane të Energjisë si dhe zbatimin e saj, dhe kjo do të sjellë shumë sfida, por besoj shumë se me ndihmën dhe kontributin e secilit prej nesh do t'i tejkalojmë së bashku", ka thënë Fejzullahu.

## Të gjithë konsumatorët që furnizohen nga KESCO kanë obligim ligjor ta rinovojnë kontratën



PRISHTINË, 6 QERSHOR - Të gjithë konsumatorët që furnizohen me energji elektrike nga KESCO e kanë obligim ligjor të lidhin kontratë të furnizimit me kompaninë. "Rregullimi i marrëdhënieve kontraktuale me furnizuesin është proces i thjeshtë dhe i lehtë për konsumatorët. KESCO ka filluar takimet dhe vizitat me konsumatorët shtëpiakë dhe ata biznesorë për t'i përditësuar të dhënat e tyre e njëkohësisht edhe duke i informuar mbi procedurat", ka njoftuar KESCO. Në këtë aspekt, KESCO apelon

tek të gjithë konsumatorët e vet që të paraqiten pranë zyrave të kompanisë, te Kujdesi për Konsumatorë dhe ta kryejnë këtë proces. Sipas njoftimit, kushdo që nuk e bën këtë brenda dy javëve që nga data e informimit prej furnizuesit, në këtë rast KESCO-s, mund të shkyçet nga rrjeti elektrik.

KESCO synon të sigurojë shërbime më të besueshme përmes iniciativës për përditësim dhe rregullimit të marrëdhënieve kontraktuale me kompaninë. "Marrë parasysh rolin e rëndësishëm që kanë të

dhënat e sakta dhe të përditësuara në sektorin e energjisë, KESCO po ndërmerr masa proaktive për ta rritur efikasitetin operacional, për ta siguruar kënaqëshmërinë e konsumatorëve dhe për ta mbështetur pajtueshmërinë rregullativ. Misioni i KESCO-s është të ofrojë zgjidhje të besueshme energjetike për konsumatorët duke nxitur kështu inovacionin dhe qëndrueshmërinë në industri dhe mbajtja e të dhënave të sakta është thelbësore për t'u arritur këto qëllime", ka njoftuar KESCO.

## Zbulohet sasia më e madhe e telefonave gjatë tentim kontrabandimit, vlera kalon 250 000 mijë euro

PRISHTINË, 6 QERSHOR - Oficerët doganorë në pikëkalimin kufitar të Vërmicës arritën të parandalonin tentim-futjen e telefonave mobilë ku vlera preliminare e sasisë së kapur kalon 250 000 mijë euro. Një ndër zbulimet më të mëdha të telefonave gjatë tentim kontrabandimit ka ndodhur të enjten, ku oficerët doganorë kanë zbuluar dhe ndaluar një sasi të madhe të pajisjeve


elektronike. Pas ndalesës së një automjeti me targa të huaja oficerët doganorë e kanë selektuar për kontroll ku së bashku me policinë kanë ushtruar kontrollin i cili ka rezultuar me këtë zbulim. Gjatë këtij kontrolli janë sekuestruar gjithsej 315 pajisje të reja, duke përfshirë: 260 telefona të markës iPhone, modele 13 dhe 15, 55 telefona të markës Samsung dhe 10 orë të zgjuara (smart watch) të

serisë IX. "Ky operacion tregon vendosmërinë e institucioneve tona për ta luftuar krimin e organizuar dhe për të siguruar që rregullat dhe ligjet të respektohen. Ne mbetemi të angazhuar për ta garantuar sigurinë dhe mirëqenien e qytetarëve tanë duke parandaluar hyrjen e produkteve të paligjshme në tregun tonë", ka njoftuar Dogana e Kosovës.





# Semiotika përmes një fjalori



Nga: Bronen MARTIN dhe  
Felizitas RINGHAM  
(parathënia e librit Fjalori i  
Semiotikës)  
Përgatiti: Albert GJOKA

Ashtu si edhe teoria letrare, Semiotika ka fituar terren në mënyrë të jashtëzakonshme gjatë dy apo tri dekadave të fundit të shekullit të njëzet. Tani ajo përdoret zakonisht duke përfshirë edukimin sekondar, programet e letërsisë dhe, për më tepër, në vëzhgimet e teorisë kritike. Koncepti është bërë pjesë e ligjërimit të medias në lidhje me filmin dhe reklamën në Europë dhe në të tërë botën. Ndonëse kërkimet teorike brenda disiplinës kanë ecur përpara, veçanërisht në Francë, akoma në shumë e shumë koncepte “Semiotika” mbetet një enigmë dhe për këtë ajo na fiton për përmbajtje. Ky libër ka për qëllim familjarizimin e studiuesve si dhe studentëve dhe pedagogëve të tyre me zhvillimet e Semiotikës.

Kjo skicë e përmbledhur e qëllimeve të teorisë semiotike, historia e saj dhe metoda e veprës është pasuar nga një seksion reference, duke ofruar përkufizime të termave dhe modeleve të përdorura në metagjuhën semiotike dhe në fund, një shembull të analizës semiotike të aplikuar në një tekst.

## Çfarë është semiotike? Çfarë kuptimi ka?

Termi semiotikë vjen nga fjala greke “semeion” që ka kuptimin “shenjë”. Në shekullin XVII, filozofi Xhon Loku iu referua semiotika, të cilën e përkufizoi si “Doktrina e shenjave”

(...) çështje prej nga ku është konsideruar Natyra e Shenjave. Mendja përdoret për të kuptuar mendimet, apo përçon dijet e saj tek të tjerët.[1]

Në përdorimin modern, koncepti semiotikë i referohet një teorie të shënjimit. Ekzistojnë disa degë të semiotikës në këtë ombrellë. Për shembull, ka një degë amerikane, e ndikuar fuqimisht nga Charles Sanders Peirce, i cili është fokusuar mbi logjikën dhe kuptimin dhe ka vënë në qendër lidhjen e gjuhësisë me filozofinë. Pjesa më e madhe e veprës së Peirce i është përkushtuar zhvillimit të kategorive të shenjave, të tilla si përmes dallimit midis Ikonës, Indeksit dhe Simbolit.[2] Kjo qasje ndryshon në mënyrë thelbësore nga semiotistët europianë, të përfaqësuar nga Shkolla e Parisit (Ecole de Paris) e themeluar nga A. J. Greimas. Shkolla e Parisit është e përqëndruar në mënyrë thelbësore në marrëdhënien midis shenjave dhe me sjelljen në të cilën ato prodhojnë kuptim brenda një teksti apo ligjërimit të dhënë.

Rëndësia është rritur jo vetëm në zhvillimin e teorisë, por edhe në aplikimin e tyre si mjete metodologjike për analizat tekstore. Krahasuar me Peirce, Shkolla e Parisit mori një qasje kërkimore më të gjerë dhe në analizën finale, është praktikisht shumë më e përdorur. Fjalori aktual është i lidhur tërësisht me teorinë dhe praktikën e kësaj shkolle.

Sipas Shkollës së Parisit, Semiotika parashtrohet ekzistencën e strukturave universale që shtrihen dhe japin shtytje ndaj kuptimit. Këto struktura janë të prekshme

ndaj përfaqësimit në trajtën e modeleve të cilat, në mënyrë të ndërsjellë, – gjithashtu mund të aplikohen te çdo objekt shënjimi për të dekoduar dhe interpretuar efektet e kuptimit të tij. Megjithatë, duke qenë e lidhur me strukturën, nuk ka kuptim që Semiotika të jetë sinonim me strukturalizmin, një teori e lidhur vetëm me perceptimin dhe përshkrimin e strukturave. Asnjë strukturë nuk është thjeshtë një sistem shenjash. Ajo nuk duhet të ngatërrohet me Semiologjinë. Po ashtu, nuk është përkufizuar as në teorinë e Roland Barthes. Në fakt Semiotika ka një qëllim shumë më të gjerë. Teoria ka për qëllim që të eksplorojë gjenerimin e shënjimit, të çdo shënjimi, jo thjeshtë vetëm të fjalës së shkruar, kuptimin në të gjithë shfaqjen e tij dhe të gjithë shtirjen e plotë të tij. Si rrjedhim, semiotika i përfshin të gjitha disiplinat dhe sistemet e shënjimit si dhe praktikën sociale dhe procedurat shënjuese.

## Semiotika dhe Shkolla e Parisit: Një histori e shkurtër

Në vitin 1985, teksta po fliste rreth zhvillimeve të teorisë semiotike, Greimas tha: Gjenia ime teorike, – gjithmonë nëse mund të quhet e tillë, është një formë “bricolage”. Unë mora pak nga Levi-Strauss dhe shtova ca gjëra nga Propp. Gjithashtu, ai tha se si gjuhëtar, ishte frymëzuar më shumë nga Dumezil dhe Levi-Strauss sesa nga gjuhëtarë të tjerë, por padyshim, me përjashtim të Sosyrit dhe të Hjelmslev.[3]

E gjitha nisi në fillim të shekullit të

XX, me gjuhëtarin zviceran Ferdinand De Saussure, që ishte i pari që aplikoi teori shkencore në studimin e gjuhës dhe lidhjet e kësaj shkence me Psikologjinë Sociale. Ajo ishte shtypa që ai të përdorte termin semiologji, të cilin ai e përkufizoi duke formuar një lidhje midis gjuhësisë dhe psikologjisë.

Saussure e shikon gjuhën si një fenomen social. Në studimin e tij, kontributi më i madh ishte zbulimi se kuptimi nuk “qëndron” te fjalët individuale, por në sistemin kompleks të marrëdhënieve apo të strukturave. Motoja e tij ishte: “Il n’y a de sens que dans la difference”. Ai nxori në pah se strukturat gjuhësore mund të eksploroohen nga të përshkruarit e tyre në formën e tyre aktuale (sinkronike) ose historike (diakronike). Ndoshta, Saussure është njohësi më i mirë për ndarjen e fenomenit të gjuhës brenda gjuhës (sistemi gjuhësor abstrakt, gjuha si sistem i strukturuar i shenjave) dhe e folura parole (shprehjet individuale, apo e folura, përmes përdorimit të sistemit abstrakt). Megjithatë, në studimin e tij gjuhësor, Saussure, shkoj më tej. Ai aplikoi parimin strukturor të shenja apo fjala individuale. Sipas tij, shenja gjuhësore është karakterizuar nga marrëdhënia e dy përbërësve: Imazhi-tingull, ose substanca materiale të cilën ai e quajti shënjuesi (signifier) dhe koncepti i tij ose i shënjuarit (signified).

Nëse Saussure dhe gjetjet e tij revolucionare[4] i shtruan rrugën strukturalizmit dhe Semiotikës, e njëjta gjë mund të thuhet për Dane Lous Hjelmslev dhe Rrethin Linguistik të Kopenhagës. Madje,

pa ndonjë lidhje të drejtpërdrejt me gjuhëtarin zviceran, përfaqësja teorike e Hjelmslevit ishte shumë afër me atë të veprës së Saussure, për të cilën mund të thuhet se ai është vazhduesi i tij. Në veprën e tij “Prolegomena, drejt një Teorie të gjuhës” (1943), ai formalizoi gjuhën, ndau fenomenin brenda “sistemit dhe “procesit”. Gjithashtu, Hjelmslev ripërcaktoi përkufizimet sosyriane të dy aspekteve të shenjës-gjuhë nga njohja e dy niveleve thelbësore ose e dy planeve të gjuhës; njëri i “shprehjes” dhe tjetri i “përmbajtjes”. Ai beson se secili prej tyre ishte zotërimi i një “substance” dhe një “forme”.

Kontributi i Hjelmslev në gjuhësi përfshin teorinë e tij të funksionit semiotik të cilën ai e përkufizoi si një ekzistim midis aspekteve dyfishe të aktit të shënjimit; – midis shënjuesit dhe të shënjuarit sipas Saussure, ose midis shprehjes dhe përmbajtjes sipas Hjelmslev. Përfundimisht, Hjelmslev zgjeroi studimet e tij semiologjike duke përfshirë edhe sisteme të tilla gjuhësore jo-verbale; të tilla si; dritat e trafikut apo tingëllimat e Big Ben-it.

Ashtu si Hjelmslev, antropologu Claude Levi-Strauss gjeti një terren të ri, të cilin ai e aplikoi me një qasje strukturaliste – gjuhësore. Levi-Strauss përcaktoi identitetin e pjesëve përbërëse të sjelljes kulturore, të cilën ai e studioi edhe si të ishte një fenomen gjuhësor. Duke kërkuar një strukturë semantike, sistem gjuhësor, apo gjuhë) që përforcon kulturën, lidhja e tij e fokusuar mbi “mitet”. Ai i analizoi mitet nga ndryshimet kulturore dhe zbuloi një numër

elementesh të përsëritura, – të cilat ai i quajti mitema “Mythemes” (siç përdoren fonemat apo morfemat në gjuhësi) dhe funksionet që duket se veprojnë si përbërës të strukturave shënjuese universale.[5]

Në të njëjtën kohë, u përkthye në anglisht një studim më i hershëm i bërë nga studiuesi rus i folklorit, Vladimir Propp.[6] Analizat e detajuara të mbi 100 përrallave e çuan atë në krijimin e një analogjie midis strukturës gjuhësore dhe organizimit narrativ. Ai identifikoi 31 funksione ose përbërës themelorë që formojnë bazën e çdo përralle. Në këtë kuptim, një funksion është një njësi e “gjuhës narrative”, e tillë, si “një detyrë e vështirë i është propozuar heroit (25) apo “shejtani është tërhequr” (30) Megjithatë, 31 funksionet janë të shpërndara mes shtatë sferave të veprimit të tilla si Shenjtani, dhuruesi, ndihmësi dhe kështu me radhë. Taksonomia narrative zhvillohet nga Proppi tek modeli i tij është konsideruar akoma i vlefshëm nga studiuesit e sotëm. Në një shtrat të tillë që frymëzuar Greimas për të përgatitur veprën themelore të asaj që u bë më vonë Semiotika: Semantique structurale (Paris; Larousse, 1966). Ky tekst paraprak përmban bazën aksiomatike të teorisë shkencore, hipotezat e parashikuara për kërkimet e mëvonshme, dhe modelet e siguruar të praktikës semiotike, duke treguar vlerat e tij si një mjet për zbulim.

Megjithatë, kjo “ouvrage fondateur” ishte vetëm fillimi. Kjo shënoi një pikë nisje të një projekti shkencor, i cili ende sot e kësaj dite është në proces zhvillimi. Përgjatë disa viteve Greimas dhe një grup studuesish të përkushtuar gjatë takimeve të tyre javore zhvillonin, testonin, ndryshonin dhe përmirësonin teorinë e shënimit. Takimet u zhvilluan në “Ecola des Hautes Etudes”, në Paris, në të cilën Greimas ishte caktuar për të dhënë leksionet e tij. Aty ishte vendi ku e pati zanafillën Shkolla Parisiane e Semiotikës.

Zhvillimet e teorisë së Semiotikës u zhvilluan në disa faza: Faza e parë u fokusua brenda kontekstit të mendimit strukturalist, mbi problematikat e semantikës si demonstrim nga vepra e Greimasit “Semantika structurale”. Nocioni i Saussure për kuptimin që vijon nga raportet, e ka frymësua Greimasin që të analizojë dhe të përcaktojë llojet specifike të diferencës. Ai identifikoi i pari dallimin e veçorive të kundërshtive në rastet e prodhimit të një tipologjie. Pjesët kundërshtuese më pas kategorizoheshin për tu përdorur si koncepte të veprës në zhvillimin e një strukture shënjuese rudimentare. Në të njëjtën kohë, takimi i papritur me veprën e Proppit e nxiti Greimasin që të aplikojë modelet gjuhësore në narrativë. Në një përpjekje për të formuluar më mirë elementet e narracionit, ai zbuloi se çfarë kishte quajtur Proppi “funksion” që në fakt ishte një aktant shtesë foljor; me fjalë të tjera, një fjali e përfunduar. Gjithashtu, ai zbuloi që ishte e mundur për të zvogëluar sferën me shtatë veprime të Proppit

në tri çiftëzime të opozicionit binar (subjekt/objekt; dërguar/marrës; ndihmës/kundërshtar) që mund të përshkruajnë çdo strukturë narrative.

Përparimet teorike u bënë gjatë kësaj faze të parë të zhvillimit në lidhje me dy hapësira të dukshme heretogjene; në njërin anë, kërkimi për një strukturë elementare të kuptimit, duke përfshirë klasifikimin logjik të dallimeve paradigmatiske; dhe në anën tjetër, duke formuluar një teori narracioni në të cilën bëhet i efektshëm modeli sintagmatik i Proppit brenda elementeve të një gramatike narrative. Gjatë fazës së dytë të kërkimit të semiotikës në vitet 1970 u bënë përpjekje për të gjetur një sintetizim midis këtyre fushave të ndryshme për të përcaktuar një teori të përgjithshme të qëndrueshme të gjenerimit të kuptimit.

Duke u përqendruar mbi strukturat sipërfaqësore të narracionit, semiotikanët zbuluan se funksioni, ashtu siç përfaqësohet nga një folje veprimi, ishte mbipërcaktuar nga foljet e modalitetit: dy të virtualizimit (dua, duhet të) dhe dy të aktualizimit (di si dhe mund të). Kur ky zbulim u shty në ekstremet e tij, rezultoi se e tërë gramatika narrative në fakt ishte përbërë thjeshtë nga modalitete plus përmbajtje që është semantika. Kjo hapi rrugën që të ndërtohen modelet e fuqishme. Për më tepër, këto modelet, mund të aplikohen gjithashtu edhe për praktika sociale, modelet e sjelljes, etj.. Narrativiteti nuk po shihej më si një pronë ekskluzive e teksteve të shkruara. Që tani e tutje ai u perceptua si një nënvizim i të gjitha ligjërimeve dhe të përlogaritjes për organizimin e botës.

Gjithashtu, kërkimet gjatë kësaj periudhe treguan se formula e përrallës së Proppit mund të zëbërthehej brenda fjalëve të rëndësishme të cilat së bashku reflektonin fazat e të gjithë veprimit njerëzor.

Fjalitë – manipulim, veprim, sanksion ishin përmbledhur brenda asaj që u bë e njohur si Skema Kanonike Narrative. Kjo ishte gjetur që të aplikohet jo vetëm të historitë, por të llojshmëria e madhe e teksteve (ligjore, gazetareske, kuzhinës etj.) dhe në fund, te diçka si një çështje bazike e njeriut për kuptimin e jetës Ndonëse eci para puna për nivelin sipërfaqësor të strukturës, gjetjet themelore mbi abstrakten apo nivelin e thellë të kuptimit treguan lidhjen e nevojës për të përsosur teorinë semiotike. Greimas propozoi një përfaqësim vizual të strukturës elementare të kuptimit: kuadratin semiotik. Kjo është shprehje logjike e çdo kategorie semantike, duke treguar të gjithë marrëdhëniet e mundshme që e përcaktojnë atë, për shembull: kundërshtimin, kontradiktën dhe implikimin. Megjithatë, ai tregoi se pavarësisht raporteve kundërshtuese, ky kuadrat gjithashtu portretizon operacionet që ata gjenerojnë. Në fakt, ai lejon ripërshkrimin e një procesi në progres apo trajektoren e një subjekti që kryen aktet e transformimit.

Me fjalë të tjera, kuadrati semiotik jo thjeshtë paraqet kategoritë e nënvizuara të kundërshtimit, por gjithashtu jep raportin e strukturave sipërfaqësore të sintaksës narrative. Në fund të viteve 1970 të gjitha gjetjet semiotike të dy dekadave të mëparshme ishin publikuar nga një vepër serioze e bërë nga Greimas dhe Joseph Courtes: “Semiotique, dictionnaire saisonne de la theorie dy language” (Paris Hachette, 1979).

Fjalori duket të jetë një provë e dukshme e konsolidimit të teorisë semiotike; konceptet e kësaj vepre ishin përcaktuar në dukje për të gjithë; modelet e tij ishin të gatshme për tu aplikuar. Megjithatë, ky nuk ishte një Kërkim në vazhdim. Shqetësimi madhor gjatë viteve pas publikimit të Fjalorit lidhej me nivelin diskursiv të kuptimit. Ky nivel lidhet në sipërfaqen figurative dhe enunciative të një fjale, e cila i jep shprehjes dhe është e mbështetur nga strukturat semiotik-narrative bazë.

Gjatë viteve ‘80 dhe ‘90 përpjekjet u përqendruan veçanërisht rreth aspektualitetit që është organizimi hapësinor, kohor dhe autorial i teksteve. Gjithashtu, në lidhje me problematikën e aspektualitetit ajo çon në ripërtëritjen e investigimit të sistemeve të vlerave. Si e bën qenia një objekt, një kohë apo një vend, që të marrë vlerë? Dhe prej kujt? Disa prej seminareve të fundit në Ecole des Hautes Etudes i ishin kushtuar studimit të të “Vërtetës” të të Bukurës”, “Zotit dhe Djallit dhe si funksionojnë këto vlera klasike në gjuhë. Ajo që u zbulua ishte se sistemi i vlerave për secilin prej tyre operon përmes linjave aspektuale të ndryshme. Për shembull, moraliteti duket se bie brenda kategorive të “të tepërtes” dhe të “pamjaftueshmërisë” ndërsa studimi i estetikës zbuloi si faktorët përcaktues aspektet e të qenit i përkryer (perfekt) ose i paplotësuar, i papërfunduar (i papërkryer). Ky zbulim ishte mbi të gjitha edhe më i rëndësishëm, ashtu si kategoritë e aspektualitetit të lidhura jo thjeshtë me ato kundërshtuese, apo binare, por graduale. Ajo nuk ishte thjeshtë një çështje e “ose” por e “më shumë ose më pak”.

Teksa gjetjet e tjera iu shtuan njohurive të semiotikës, ato gjithashtu sfiduan konceptet e mëparshme të bazave të logjikës së strukturës elementare të shënimit. Në vitin 1983 Greimas shkroi një artikull me titullin: “Le Savoir et le Croire: un seul univers cognitif”, në të cilin ai prezantoi për herë të parë kuadratin semiotik, i bazuar mbi transformimin gradual dhe jo mbi fazat kontradiktore apo kundërshtuese.[7]

Në vitin 1986 u publikua libri i dytë i semiotikës, i titulluar: “Semiotique, dictionnaire raisonne de la theorie du language”. Ai reflekton një numër të madh kontribuesish të përfshirë deri më tani në kërkime dhe një shkencë që është akoma në një proces kërkimi për të qenë përcaktuese. Në vitet e tij të fundit, semiotika e Greimasit përqendrohet në sferat e pasioneve dhe të timikes. Pasionet nuk përshkruhen më tej në termat

e strukturave modale; ai dhe kolegët e tij tani kanë hyrë në riinterpretimin e tyre në konceptet e aspektualitetit dhe të sekuencave diskurseve specifike. Njëkohësisht, janë bërë përpjekje për të përcaktuar nivelet e thella të aspektualiteteve, të cilat lidhen me valorizimet specifike.

Greimas u nda nga jeta në vitin 1992. Ne kemi dhënë vetëm një skicim tejet të shkurtër të hetimeve të tij semiotike dhe të asaj që në Paris është quajtur teoria bazë e semiotikës. Nga një kuptim, vepra është e papërfunduar dhe studimet vazhdojnë ende. Megjithatë, gjetjet në të ardhmen, apo edhe sfidat, nëse do të ketë, nuk do të jenë në gjendje të ndryshojnë përshkrimin e projektit shkencor të Greimasit të përcaktuar për veten e tij dhe për ne, që është studimi i semiotikës i cili është përkufizuar si teoria e shënimit. (theorie de la signification “Son souci premier sera d’expliciter, sous forme d’une construction conceptuelle, les conditions de la saisie et de la production de sens...”).[8]

### Semiotika si një mjet për analizë

Çfarë është përfaqësia semiotike? Si e bën ajo punën? Semiotika merret si një premisë thellore e asaj që atje nuk mund të ketë kuptim pa diferencën. Nuk mund të ketë “lart” pa “poshtë”, “ngrohtë” pa “ftohtë”, apo “Zot” pa “Djall”. Ja si e thotë Greimas:

Ne perceptojmë diferencat (ndryshimet) dhe falë këtij perceptimi, bota ‘merr formë’ përpara nesh dhe për qëllimet tona.

### Ekzistojnë katër parime bazë mbi të cilat është mbështetur analiza semiotike e teksteve:

Kuptimi nuk është natyrë e vet të objektet; objektet nuk shënjohen nga vetja e tyre. Përkundrazi, kuptimi është i ndërtuar nga ajo që është njohur si një kompetencë vëzhguese; për shembull, nga një subjekt i aftë për t’ju dhënë formë objekteve. Le të japim një shembull. Ballafaqimi me një formë aplikuese prej një kulture e ndryshme, të themi, afrikane apo aziatike, që ndoshta ne duhet të jemi të paaftë për të përfituar nga shënjueshmëria e saj. Megjithatë, vetëm duke u larguar prej saj, ne do t’i japim asaj një kuptim që është i mbështetur në atë njohje që ne kemi dhe në atë që i përshtatet qëllimit tonë.

Semiotika e sheh tekstin, madje, çdo tekst, si një njësi autonome, dhe që është në koherencë të brendshme. Duke ecur me tej; idetë /kuptime të jashtme të tekstit dhe duke shfaqur sesi ato janë reflektuar brenda tij, një përafrim që është akoma i pranuar gjerësisht në botën akademike, analiza semiotike nis me një studim të gjuhës dhe strukturave aktuale të tekstit, duke treguar sesi janë ndërtuar kuptimet, dhe sigurisht, në të njëjtën kohë, çfarë kuptimesh kanë. Më tej, analiza semiotike bëhet një metodë zbuluese dhe

është qartësisht një mjet i paçmuar për të gjithë ata që përfshihen në kërkime origjinale.

Semiotika parashtron se çdo strukturë historie apo narrativiteti gjendet poshtë të gjitha ligjërimeve, jo pikërisht në atë se çfarë është zakonisht njohja si një histori. Për shembull, ajo qëndron poshtë ligjërimeve politike, sociologjike dhe ligjore. Madje, mund të thuhet se narrativa qëndron në bazën e konceptit tonë të së vërtetës: Për shembull, studimet e fundit në fushën e diskursit ligjor kanë treguar se ata dëshmitarë në gjykatë, tregimi i të cilëve përshtatet më shumë me modelet arketipale të tregimit, janë ata të cilëve ka më shumë gjasa t’iu besohet versioni i tyre.

Semiotika parashtron nocionin e niveleve të kuptimit. Për shembull, është niveli abstrakt i thellësisë që prodhon nivelet sipërfaqësore. Prandaj, një tregim duhet të studiohet në të gjitha nivelet e ndryshme të thellësisë dhe jo vetëm në nivelin sipërfaqësor, siç është bërë e zakonshme me gjuhësinë tradicionale.

Duke mbajtur në mendje këto parime, analiza semiotike është ndihmues më tej nga “skema” apo “modele”, aplikimi i të cilave kontribuoi në dekodimin e kuptimit të teksteve. Ne do të japim një analizë të shkurtër të rëndësisë së madhe të këtyre skemave dhe modeleve dhe do të shpjegojmë sesi ato lidhen në nivele të ndryshme tekstuale.

### Nivelet ligjërimore (diskursive)

Niveli ligjërimitor është një nivel sipërfaqësor i kuptimit, apo një nivel manifestimi. Këtu ne shqyrtojmë fjalët specifike, apo strukturat/njësitë gramatikore që janë të dukshme në sipërfaqen e tekstit. Pjesa më e madhe e mësuesve të gramatikës – the analistëve të vërtetë tekstorië, – deri më tani kanë qenë të shqetësuar vetëm për këtë nivel. Elementet kyçe në këtë nivel janë:

Komponenti figurativ: nga ky ne kuptojmë të gjithë elementet në tekst që i referohen botës së jashtme fizike. Ato janë njohur si figura. Veç kësaj, realiteti figurativ është ai realitet që mund të perceptohet përmes pesë shqisave; shikimit, nuhatjes, dëgjimit, të shijuarit dhe prekjës. Ai mund të jetën në kontrast me botën e brendshme konceptuale – abstrakte që është niveli i tretë dhe i thellë i kuptimit.

Për të eksploruar elementin figurativ ne e nisim me shqyrtimin e fjalorit. Ne përpiqemi për të nxjerrë fushat më të rëndësishme leksikore (semantike). Kjo është bërë duke i grupuar së bashku fjalët që kanë një kuptim të përbashkët ose një emërues të përbashkët. Këto grupime janë quajtur izotope (vjen nga frëngjishtja, isotopies). Listat e izotopeve mund të jenë të interpretueshme: Si janë të shpërndara ato në tekst? Cila është/janë dominante mbi tjetrën/të tjerat? A mund të nxjerrim kundërshti në këtë nivel? Tashmë, ky lloj interpretimi mund

të na japë një tregues të atyre që do të jenë tema të rëndësishme.

Tiparet gramatikore/sintaksore: Për shembull, përdorimi i zërave aktivë dhe pasivë apo procedurave si shkruet normalizues dhe kohezivë hedhin dritën mbi organizimin e një teksti dhe kështu zbulojnë strategjitë tekstore të manipulimit.

Komponenti enunciativ. Ky lidhet me gjurmët e autorit/folësit dhe dëgjuesit/lexuesit në tekst. Çfarë imazhi shfaqim gjatë realizimit të të folurit të tyre? Hetimi i përemrave, zërave narrative (personalizimi apo depersonalizimi) i formave të të folurit (direkt/indirekt) për shembull shfaqja në mënyrë të qëllimshme e shënjitimit. Gjithashtu, më i rëndësishëm në këtë aspekt është modaliteti i një deklaratë, për shembull modaliteti kategorik në rastin e raportimit të lajmeve, apo i pasigurt në rastin e një nxënësi, etj.

**Niveli narrativ**

Ky nivel është më i përgjithshëm dhe më abstrakt sesa niveli ligjërimit (diskursiv). Ai është niveli gramatikor i historisë apo i sintaksës sipërfaqësore narrative, i një strukture që (sipas Shkollës së Parisit) rrok të gjithë ligjërimit, që mund të jetë shkencor, sociologjik, artistik, etj.

Analiza semiotike e këtij niveli kuptimi realizon përdorimin e dy modeleve themelore narrative: (1) Skemën Narrative Aktanciale dhe (2) Skemën Narrative Kanonike.

Këto modele bashkërisht, artikulojnë strukturën e çështjes, apo për të qenë më të saktë, të programit global narrativ të çështjes. Për shembull, ato mund të aplikohen te një ekstrakt, një paragraf i vetëm apo te i tërë teksti. Fillimisht, ne do të shqyrtojmë Skemën Narrative Aktanciale. Kjo skemë paraqet gjashtë funksione narrative kyçe (role aktanciale) të cilat bashkë llogariten për të gjitha marrëdhëniet e mundshme brenda një historie dhe në të vërtetë brenda sferës së veprimit

novelë apo artikull gazete.

**2. Ndhimës/kundërshtar**

Subjekti mund të ndihmohet ose pengohet në kërkimin e tij. Sërish këto pozicione aktanciale mund të jenë ndihmuar nga objekte ose cilësi të brendshme, ashtu si edhe nga njerëz. Paraja, apo kusaraja mund të jenë ndihmës apo pengesë për kundërshtarin tim. Një variant i kundërshtarit është anti-subjekti. Një anti-subjekt është një subjekt që për të arritur qëllimet e tij, pengon kërkimin e një subjekti tjetër. Marrëdhëniet mes subjektit / anti-subjektit karakterizojnë të gjithë fiksinin dhe pjesën më të madhe të artikujve të gazetave apo lajmeve të televizionit. Sigurisht, ai është skenari i heroit/horrit.

**3. Dërguesi / Marrësi**

Dërguesi është një aktant (person/ide) që motivon një veprim apo një shkak, diçka që ndodh. Me fjalë të tjera, dërguesi provokon veprimin, xhit dikë që të veprjë. Dërguesi i përcjell marrësit dëshirën për të vepruar (vouloir jaire) ose nevojshmëri për të vepruar (devoir jaire) Ne e quajmë dëshirë ose detyrim të aktit të mundësive. Ajo çfarë dimë është si një kontratë e vendosur mes dërgesit dhe marrësit. Pastaj, në bisedimin e njerit (ose të të dyjave) faktori përcaktues i modalitetit është transformuar brenda një subjekti të gatshëm për të nisur kërkimin. Ne do të ndalemi tani te Skema Kanonike Narrative. Kjo paraqet në detaje fazat e ndryshme të çdo kërkimi:

**Kontrata**

Dërguesi motivon veprimin, duke komunikuar modalitetet e dëshirave ose detyrimeve të marrësi. Një kontratë është krijuar; marrësi bëhet një subjekt dhe nisat në kërkim. Kontrata pasohet nga tre teste:

për të vepruar (pouvoir / faire) dhe ose njohuri / aftësi (savoir / faire) për ta kryer atë. Për shembull, në qoftë se synimi juaj është për të qëlluar dikë, së pari ju duhet të keni një armë. Funksionet e armës, si ndihmësja e juaj, ju ofrojnë aftësinë e nevojshme për të vepruar. Megjithatë, ju duhet të dini si të qëlloni, përndryshe arma është e padobishme. Duke qenë në gjendje ta bëni dhe duke ditur sesi ta bëni, – njihen si modalitete.

**2. Testi vendimtar**

Ky paraqet ngjarjen apo veprimin e përgjithshëm për të cilin subjekti ka qenë përgatitur kur objekti i kërkimit është në rrezik. Në historitë aventureske, apo artikujt e gazetave, shpesh herë testi vendimtar merr formën e një konfrontimi apo konflikti mes një subjekti dhe një anti-subjekti.

**3. Testi i shpalljes**

Kjo është faza në të cilën është shpallur rezultati i ngjarjes. Testi vendimtar ka pëfunduar me sukses ose dështim. Me fjalë të tjera, kjo është pika në të cilën performanca e subjektit është

mandatuarin e parë dhe së dyti, përdërguesin (sender-adjudicator). Këto role nuk luhen domosdoshmërisht nga i njëjti aktor apo person.

Kur aplikohen këto modele narrative themelore në tekst, është e rëndësishme për të ditur disa gjëra:

Çdo tekst individual i shfrytëzon këto skema në mënyrën e vet. Është shumë domethënëse se cilat etapa të kërkimit janë të qarta ose të shfaqura në tekst dhe cilat janë të nënkuptuara. Media, për shembull, ka tendencë të nxjerrë në pah etapën e performancës (testi vendimtar) dhe etapën e sanksionit (testi glorifikues).



Korrelacionet mund të bëhen më nivelin ligjërimit. Elementet figurativë që kanë dalë si izotopitë mbizotëruese, apo opozicionet përcaktuese, në nivelin narrativ mund të marrim pozicionet e objektit apo subjektit të kërkimit. Jo të gjitha historitë apo kërkimet përfundojnë. Një kërkim mund të dështojë përmes ndërhyrjes së suksesshme të anti-subjektit. Nëse e keni vendosur për të lundruar nëpër botë dhe barka juaj përmbysset, në mënyrë të papritur, kërkimi juaj ndërpritet.

marrëdhëniet kundërshtuese (opozicionale), kontradiktore dhe ndërlikohet është shprehje logjike e çdo kategorie semantike.

S1 dhe S2 janë në një marrëdhënie opozicionale ose kundërshtuese (një term presupozon tjetrin); S1 dhe – S1 janë të marrëdhënie kundërshtie – S1 mohan S1. S2 dhe – S2 anë gjithashtu në marrëdhënie kundërshtie: – S2 mohan S2; S1 dhe S2 janë në marrëdhënie përfshirëse: – S1 përfshin S2. Në mënyrë të ngjashme, – S2 përfshin S1. Kuadrati semiotik është një mjet i dobishëm për të ilustruar kundërshtitë themelore apo përjashtimet tematike duke u mbështetur te teksti. Gjithashtu, ai e bën atë të mundshme, përmes shfaqjes së dinamikave tekstuale apo transformimeve në një histori dhe për të ndjekur trajektoren narrative të subjektit. /Palimpsest.al/

[1] John Locke, Një ese rre kuptuarit njerzor, red. Pet Nidditch (Oxford: Clarendon Press, 1975/1979), Libri IV, XXI, fq. 720.

[2] Idet° e Peirceit kan° ndi



njerëzor në përgjithësi. Skema është thjeshtëzim i shtatë sferave të veprimit të Proppit apo rolet, të cilat u trajtuan nga studimi i përrallave popullore ruse, të tilla si ajo e heroit, shejtanit, ndihmësit, etj.. Diagrama i përshkruan marrëdhëniet si më poshtë:

**1. Subjekt/Objekt**

Kjo është marrëdhënia më themelore. Aty nuk mund të ketë subjekt pa objekt dhe anasjelltas. Një subjekt shkon në kërkim të një objekti.

Objekti i çështjes mund të jetë konkret – një person apo një gjë – por mund të jetë edhe abstrakt, i tillë si dija, e vërteta apo dashuria. Për shembull, zakonisht ekziston më shumë se një subjekt dhe më shumë sesa një çështje; një

KONTRATË/MANIPULIM	KOMPETENCË	PERFORMANCË	SANKSION
Të bërit bindës të dërguesit	Testi i kualifikimit	Testi vendimtar	Testi i fitores
Realizimi i një dëshiroje të bëj	Forcimi i dëshirës	Ngjarja kryesore ku vlera e objektit është në rrezik	Performanca e subjektit është e njohur (vlerësim/jo-vlerësim, sukses/dështim)
Duhet të bëj	Arritja e të qenit i aftë për të bërë dhe/ose për të ditur sesi ta bësh		

**1. Testi i kualifikimit**

Subjekti duhet të ketë kompetencën e nevojshme për të kryer veprimin apo misionin e planifikuar. Dëshira apo detyrimi për të vepruar në vetvete është e pamjaftueshme. Subjekti duhet të posedojë aftësinë

interpretuar dhe vlerësuar nga ai që njihet si përdërgues (sender-adjudicator). Përdërguesi gjykon nëse performanca është në përputhje me përmbajtjen origjinale të vlerave (ideologjinë apo mandatimin), i institucionalizuar nga dërguesi fillestar. Për të dalluar këto dy dërgues, ne thërrasim fillimisht të


shpeshherë si niveli tematik. Ky është niveli sintaksor abstrakt apo konceptual, ku janë të artikuluara vlerat themelore që prodhon një tekst. Këto vlera mund të shfaqen në formën e një Kuadrati Semiotik. Kuadrati semiotik është një shfaqje vizuale e strukturës elementare të kuptimit. Të artikuluarit e

n° vepr°n e Umberto Ecos, q° zhvilloi iden° e trupit dhe kontestoi kategorit° e Peirce [3] Algirdas J. Greimas, Mbi kuptimin, Historia e Let°rsi Re, 20 (1989), 539-50 (fq. 54 [4] Ata kan° regjistruar leks n° Kursin e Gjuh°sis° s° P°rgjithshme t° Saussureit, t cilat u bashkua nga sh°nimet marra nga leksionet e student t° tij n° Universitetin e Gje midis viteve 1906- 11 dhe u publikuan pas vdekjes s° tij, vitin 1915.

[5] Shiko gjithashtu, Claude Strauss, Antropologjia strukturale (Paris: Plon,195 [6] Vladimir Propp, Morfolog p°rrall°s (Bloomington: Indi University Press, 1958).

[7] Shkrimi i Greimas °sht° riprodhuar n° Du Sens II (P Seuil, 1983), fq. 115-33.

[8] Teoria e shenjifikimit: kryesor i saj duhet t° jet° p sqaruar p°rmes nd°rtimit konceptual kushtet p°r prodhi dhe arritjen e kuptimit, Fja 1979, fq. 345.



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

## Pezullohet tenderi për renovimin e stadiumit të Gjilanit

Gjilan, 6 qershor - Është pezulluar sërisht tenderi për renovimin e stadiumit të qytetit të Gjilanit. Procesi tenderues është pezulluar për shkak të ankesës së një operatori ekonomik, ku ky i fundit ka ofruar çmim më të lirë sesa operatori i rekomanduar për kontratë. Kjo u bë e ditur pasi zyra e Prokurorit të komunës së

Gjilanit ka publikuar dokumentin. "Pezullohet aktiviteti i prokurimit me titull 'Renovimi i Stadiumit të qytetit të Gjilanit'", thuhet në njoftim.

Ndër të tjera, në njoftim thuhet se vendimi do të hyjë në fuqi në ditën e nënshkrimit dhe se do të jepet informacione për hapat e mëtejshëm. "Për hapat e tjerë

lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, me kohë do të jeni të informuar përmes platformës së prokurimit elektronik. Ky vendim do të hyjë në fuqi ditën e nënshkrimit dhe të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike të prokurimit", thuhet në njoftim.

Rinovimi i stadiumit të qytetit në

Gjilan ka filluar nga viti 2017, derisa disa herë janë anuluar tenderët e shpallur. Dy klubet gjilanasë që bëjnë gara në Superligën e Kosovës, Drita dhe Gjilani, kanë dy vjet që tani luajnë në stadiumin me bari sintetik në Gjilan, stadium që nuk plotëson kushtet. Si Drita ashtu edhe Gjilani disa herë kanë ngritur zërin për



renovimin e rinovimit të stadiumit, megjithatë kërkesat e tyre dhe qytetarëve të Gjilanit kanë hasur në veshë të shurdhër tani e shtatë vjet.

## Sylvinho para miqësore ndaj Azerbajxhanit: Do të bëj ndryshime në formacion

### "Epoka e re"

SZOMBATHELY, 6 QERSHOR - Kombëtarja e Shqipërisë e zhvillon sonte (e premte) ndeshjen e fundit miqësore para Kampionatit Evropian "Euro 2024". Kuqezinjtë përballen me Azerbajxhanin në stadiumin "Haladas Sportkomplexum" në Hungari nga ora 19:00. Trajneri Sylvinho ka thënë se në këtë miqësore do t'u japë më shumë hapësirë lojtarëve që kanë pasur pak minuta në dispozicion. "Ne jemi duke zhvilluar përgatitjen për Evropianin dhe kishim në program dy miqësore. Është një proces pune shumë i shpejtë për ne, për stafin teknik, për lojtarët. Nuk është se kemi pasur 3-4 javë në dispozicion për t'u përgatitur për Evropianin. Kemi 7 ditë që stërvitemi, mes tyre janë edhe miqësoret. Ne po përgatitemi për ndeshjen me Italinë, por nuk mund të them si do të jetë skuadra, kush do të jetë



Shqipëria në atë ndeshje. Kemi edhe pak ditë kohë deri në ndeshjen me Italinë dhe mbetet për t'u parë si do të vijnë gjërat deri në atë moment. E rëndësishme është që në ndeshjen me Azerbajxhanin t'u japim mundësinë lojtarëve,

sidomos atyre që nuk kanë luajtur shumë minuta, të provojmë sa më shumë gjëra të reja. Është një proces shumë dinamik, shumë i shpejtë për Kombëtaren. Këto miqësore na japin një mundësi të shohim se ku jemi dhe do të na ndihmojnë shumë që të

përgatitemi se ku jemi", ka thënë Sylvinho, i cili ka folur edhe për ndeshjen e parë në Evropian ndaj Italisë: "Italia është skuadra kampione në fuqi e Evropës. Sigurisht që është një ndeshje shumë e vështirë. Po përgatitemi të përballemi si duhet me Italinë,

një nga ekipet më të forta në Evropë dhe botë, ashtu sikurse Kroacia dhe Spanja që janë në grupin tonë. Është një grup shumë i fortë, shumë i bukur për Shqipërinë, për të gjithë ne, stafin, lojtarët. E rëndësishme është që ta shijojmë këtë pjesëmarrje të dytë në finale të një turneu të madh si Evropianin, të provojmë të bëjmë më të mirën në turne". Në konferencë për medie ishte edhe sulmuesi Taulant Seferi, i cili u shpreh se ekipi po përgatitet dhe po punon shumë fort në këtë fazë përgatitore, siguroi se e gjithë skuadra do ta japë maksimumin në finale të Evropianit. "Gjatë kësaj periudhe kemi punuar shumë fort, me intensitet të lartë me të gjithë stafin. Është krenari të jesh pjesë e Kombëtares, ndjesi shumë e mirë. Ajo çfarë ka më shumë rëndësi është që jemi të gjithë bashkë dhe jemi shumë të lumtur që jemi këtu dhe mezi po e presim Evropianin. Po punojmë fort", ka deklaruar Seferi.

## Kosova në turneun e YDF-së në Turqi

PRISHTINË, 6 QERSHOR - Kosova në të dyja konkurrencat për U14 do të marrë pjesë në turneun e YDF-së. Ky turne, që është përkrahur nga FIBA, kësaj radhe do të zhvillohet në Turqi nga 6 deri më 10 qershor. Në këtë turne do të marrin pjesë Kosova, Bullgaria, Rumania, Turqia dhe Maqedonia Veriore në të dyja konkurrencat. Para udhëtimit

në Turqi janë përzgjedhur 12 lojtarët/et që do ta përfaqësojnë Kosovën në këtë turne të FIBA-s nga trajnerët Driton Obërtinca te meshkujt dhe Hasan Bytyqi te femrat. FBK-ja dhe FIBA YDF kanë bashkëpunim që nga viti 2016, i cili ka ndihmuar në zbulimin e talenteve të rinj, edukimin e trajnerëve dhe ngritjen profesionale të lojtarët.

### ORARI

6 qershor	13:00 Kosova-Bullgaria (femrat)
	15:00 Kosova-Bullgaria (meshkujt)
7 qershor	16:00 Turqia-Kosova (femrat)
	18:00 Turqia-Kosova (meshkujt)
8 qershor	12:00 Rumania-Kosova (femrat)
	14:00 Rumania-Kosova (meshkujt)
9 qershor	10:00 Kosova-Maqedonia Veriore (femrat)
	14:00 Kosova-Maqedonia Veriore (meshkujt)



## Krasniqi nga Rapidi kalon te Sparta Pragës

PRAGË, 6 QERSHOR - Futbollisti i Përfaqësueses së Kosovës, Ermal Krasniqi, do të jetë lojtari më i ri i Sparta Pragës. Kampioni i Çekisë ka arritur marrëveshje me Rapidin Bukureshtin për transferimin

e tij për rreth dy milionë euro, ka raportuar të enjten "Sport.ro". Kësaj shume mund t'i shtohen edhe bonuse të tjera, me vlerë 300 mijë euro të tjera, varësisht nga paraqitjet e kosovarit në

Sparta Pragë. Rapidi ka ruajtur edhe një përqindje të një transferimi të ardhshëm të Krasniqit. Transferimi i sulmuesit kosovar te kampioni në fuqi i Çekisë pritet të zyrtarizohet këtë

javë. Ndryshe, Krasniqi këtë sezon luajti në 34 ndeshje për CFR Cluj dhe Rapid, duke arritur të shënojë në gjashtë prej tyre, shifër së cilës i shtohen edhe pesë asistime vendimtare.



## Rrahmani pritët të bëhet transferimi më i shtrenjtë në histori të Rapidit

**BUKURESHTI, 6 QERSHOR** - Albion Rrahmani ka impresionuar me fanellën e Rapid Bukureshtit, duke shënuar 17 gola dhe duke kontribuar me gjashtë asistime në 26 ndeshje. Disa skuadra të rëndësishme në Evropë janë duke interesuar për sulmuesin e Rapidit, i cili

vlerësohet me 3.5 milionë euro nga faqja e specializuar "Transfermarkt". Sipas mediumit rumun "Digi Sport", skuadra çeke e interesuar për Rrahmanin është Slavia e Pragës, por ka ofruar vetëm tre milionë euro, ndërsa Rapidit kërkon rreth tetë milionë euro.

Kështu, duke qenë se diferenca mes dy palëve është mjaft e madhe, është e vështirë të besohet se sulmuesi nga Kosova do të shitet në Çeki. "Lewa" i Kosovës mund të shitet në Skoci, ku e interesuar është Glasgow Rangers dhe është

gati të ofrojë gjashtë milionë euro. Drejtuesit e Rapidit kanë deklaruar se Rrahmani do të bëhet transferimi më i shtrenjtë në historinë e klubit, një rekord që aktualisht mbahet nga Rares Ilie (21 vjeç), futbollist i shitur te OGC Nice për 5 milionë euro.



## Lansohet kampanja 'Evropianët e artë' në prag të Lojërave Olimpikë 'Parisi 2024'

**PRISHTINË, 6 QERSHOR** - Lojërät Olimpikë "Paris 2024" po afrohen, kurse ekipi olimpiq i Kosovës po vazhdon përgatitjet për pjesëmarrjen e tretë në Lojërät Olimpikë Verore. Në kuadër të përgatitjeve, kur kanë mbetur edhe 50 ditë deri në LO Paris 2024, Komiteti Olimpik i Kosovës ka lansuar kampanjën #GoldenEuropeans (Evropianët e artë), në kuadër të së cilës do të zbulohen aktivitetet e shumta që na presin deri në "Paris 2024". Me këtë rast, zëdhënësi për media në Komitetin Olimpik të Kosovës, Kushtrim Krasniqi, në një konferencë për medie ka thënë se ky slogan është i frymëzuar nga historia e suksesshme e Kosovës në Lojërät Olimpikë. "Sot siç po e shihni janë edhe 50 ditë deri në Lojërät Olimpikë 'Parisi 2024' dhe pikërisht në këtë ditë kemi vendosur që ta lansojmë kampanjën 'Goldeuropeans'. Pse kemi ardhur përfundim të këtij



slogan? Frymëzimin kryesor e kemi gjetur te historia jonë e suksesshme në Lojërät Olimpikë. Siç edhe e dini, në vetëm dy pjesëmarrje në Lojërät Olimpikë Verore, Kosova si një vend i vogël ka arritur t'i fitojë tri medalje dhe të tria të arta, të tria nga vajzat tona nga sporti i xhudos. Pra, falë këtij suksesi, kemi ardhur në përfundim që në rrugëtimin tonë drejt 'Paris 2024', ekipi ynë i Kosovës ta bartë me vete këtë slogan i cili

besojmë shumë se do të jetë një motiv shtesë për të gjithë ekipin olimpiq të Kosovës", ka thënë Krasniqi. Deri te nisja zyrtare e Lojërave Olimpikë "Parisi 2024", Komiteti Olimpik do t'i zhvillojë disa aktivitete. Ndryshe, Lojërät Olimpikë "Parisi 2024" do të zhvillohen nga data 26 korrik deri më 11 gusht dhe Kosova atje synon të rrëmbejë medalje elitare, sidomos në sportin e xhudos.

### SHKURT

#### Ter Stegen: Zhgënjyese të jesh rezervë

Fakti që portier i parë te Gjermania në Evropian do të jetë Manuel Neuer, ka shkakuar pakënaqësi te "gardiani" i Barcelonës, Marc-Andre ter Stegen. "Të jesh rezervë është shumë zhgënjyese. Nuk është situatë e këndshme. Unë e pranoj vendimin edhe nëse nuk jam dakord, në fund kam përgjegjësi ndaj grupit për të ndihmuar në çdo mënyrë të mundshme. Unë i thashë trajnerit se një gjë është sportive dhe një tjetër është njerëzore, dua që të gjithë të kenë besim tek unë", ka thënë Ter Stegen, i ka mohuar se ka probleme me Neuerin. "Jo, nuk ka lidhje me të. Në planin personal ne kemi një marrëdhënie të mirë. Është një problem i njohur në pozicionin e portierit. Nuk ka pasur kurrë një trajner që ka hedhur në fushë dy portierë njëkohësisht (qesh). Vendimi është gjithmonë i vështirë", ka shtuar Ter Stegen.

#### Haaland: Kam edhe tri vjet kontratë me Cityn

Erling Haaland e sheh të ardhmen në skuadrën e Manchester City. Duke folur për "TV2", sulmuesi norvegjez ka deklaruar se ka pasur dy vjet shumë të mira në klubin anglez, derisa ka kontratë edhe për tri vjet të tjera. "Kam pasur dy vjet fantastike te Manchester City. Më kanë mbetur edhe tri vite të tjera. Kjo është me të vërtetë gjithçka që mund të them. A po zhvillohen negociata? Kjo është gjithçka që mund të them. Kjo që sapo thashë", ka deklaruar Haaland. Ylli norvegjez u transferua në Manchester City nga Borussia Dortmund, në verën e vitit 2022 për 51 milionë sterlina. Ai ka ende tri vjet në kontratën ekzistuese (deri më 30 qershor 2027).

#### Laporta: Flick më premtoi suksese të mëdha këtë sezon

Presidenti i Barcelonës, Joan Laporta, i intervistuar nga e përditshmja spanjolle "Mundo Deportivo", në prag të sezonit të ri, ka folur për zgjedhjen e tij për të emëruar në krye të stollit gjermanin Hansi Flick, si dhe për objektivat që ata kanë. "Mendojam se gjëja më e mirë për klubin tonë ishte një trajneri i ri, i cili besonte te ky grup futbollistësh. Në momentin kur kuptuam se alternativë ishte edhe Flick, nuk hezitua për të kontaktuar dhe për ta nënshkruar marrëveshjen. Ai na dha shumë besim, që me grupin e futbollistëve që kemi aktualisht në dispozicion, mund të arrij suksese të mëdha. Ai është serioz, i përgjegjshëm dhe shumë i pjekur", ka thënë Laporta.

#### Maddison jashtë listës përfundimtare për 'Euro 2024'

James Maddison është lënë jashtë skuadrës me 26 lojtarë të Anglisë për "Euro 2024" dhe është larguar nga kampi i "Tre Luanëve". Mesfushori i Tottenhamit është emri i parë nga skuadra e përkohshme e Gareth Southgate me 33 lojtarë që nuk ka arritur në finalen e turneut në Gjermani. Southgate duhet ta zvogëlojë skuadrën e tij të zgjeruar në 26 emra deri në orën 23:00 të së premtes, një orë pas miqësorës së Anglisë në "Euro 2024" kundër Islandës në "Wembley". Anglia më pas fillon fushatën e saj në "Euro 2024" më 16 qershor kundër Serbisë.

## Usyk: Pas revanshit me Furyn do të largohem

**SIMFEROPOL, 6 QERSHOR** - Boksieri ukrainas Oleksandr Usyk ka shokuar fansat duke zbuluar se dëshiron të bëjë një ndryshim të madh në karrierë pas revanshit me Tyson Fury, në fund të këtij viti. Ai u bë kampion i padiskutueshëm në peshën e rëndë, pas fitores me vendim shumice ndaj Furyt. Dhe Usyk ka lënë të kuptohet se sfida e tij e dytë me Furyn mund të jetë e fundit në peshën e rëndë. Ukrainasi po mendon seriozisht të rikthehet në peshën e mëparshme, atë "cruiserweight", ku gjithashtu ishte kampion i padiskutueshëm. Usyk nuk ka asnjë humbje në karrierën e tij. Duke folur për mediet, ukrainasi ka thënë: "Mendoj se, ndoshta pas revanshit,



do të zbres në peshën time 'cruiserweight'. Unë e dua më shumë atë peshë. Mund të jem sërish kampion bote në atë Divizion. Ky është plani im, pasi kur nis përgatitjen për ndonjë duel në peshën e rëndë duhet të ha çdoherë. Për mua është e vështirë". Usyk është natyrisht më i vogël për kategorinë e peshave të rënda dhe duket qartë se e ka të vështirë

të shtojë peshë për t'u përballur me burra të përmasave të tilla si Tyson Fury dhe Anthony Joshua. Fury ishte 18 kg më i rëndë se Usyk në duelin që ata zhvilluan në Riad më 18 maj. Një fitore e dytë ndaj Fury do ta linte ukrainasin me dy fitore ndaj dy emrave më të mëdhenj të Divizionit, ndaj dhe motivimi për të vazhduar në peshën e rëndë mund të mos ketë më. Usyk u pyet, gjithashtu, nëse Tyson Fury ishte lufta e tij më e vështirë dhe më e forta që është goditur. "Lufta më e ashpër, po. Grushti më i madh, jo. Sepse Derek Chisora ishte një rival shumë i ashpër. Kur mora një grusht prej tij unë thashë: 'O Zot. Si një shkop bejsbolli', është shprehur Usyk.

## Gjykata ndalon shitjen e 'Topit të Artë' të legjendës Maradona

Gjykata e Apelit në Versajë vendosi ta ndalojë ankandin e "Topit të Artë" të vjedhur, i cili u fitua nga futbollisti legjendar argjentinas Diego Armando Maradona në vitin 1986. Konkretisht, gjykata pranoi ankesën e dy vajzave të Maradonës, të cilat pretendojnë se

"Topi i Artë" është pronë e familjes së futbollistit të ndjerë dhe se nuk mund të shitet në ankand. Ai fitoi "Topin e Artë" si lojtari më i mirë në Kupën e Botës 1986 në Meksikë, ku udhëhoqi Argentinën në Kampionatin Botëror. Pothuajse të gjitha

ndeshjet e tij në atë kampionat ishin legjendare, sidomos ndeshja kundër Anglisë ku shënoi një gol të njohur si "Dora e Zotit" dhe tjetrin pasi dribloi shumë futbollistë anglezë. Kujtojmë se Maradona vdiq në vitin 2020 dhe trashëgimtarët e tij pretendojnë

se "Topi i Artë" është vjedhur dhe pretendojnë se pronari aktual nuk ka të drejtë ta shesë atë. Meqë ra fjala, kishte spekulime të ndryshme rreth atij trofeu dhe thuhej se Maradona e humbi atë në një lojë pokeri ose se e shiti për t'i shlyer borxhet e tij. Thuhej,

gjithashtu, se Maradona e mbante atë në një bankë në Napoli, e cila ishte grabitur nga kriminelët vendas gjatë vitit 1989, ndërsa ai luante për Napoli dhe trashëgimtarët e tij besojnë se trofeu ishte vjedhur nga banka.



# Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook



[www.facebook.com/gjejpuneshpeite](http://www.facebook.com/gjejpuneshpeite)

## RESTAURANT

# SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156  +386 49 848 553

PRISHTINË

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, Kompania "Pin Group Arch" Sh.p.k. Gjurgjevik i Vogël, Klinë, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën organizojnë:

### DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për impiantin fotovoltaik me kapacitet 2MW në Klinë dhe Zllakuqan.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 26.07.2024 në ora 11:00 në Shkollën e Mesme Teknike "Fehmi Agani" Klinë, do të organizohet debat publik nga Kompania "Pin Group Arch" Sh.p.k. Gjurgjevik i Vogël, Klinë, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

Linku:

<https://us04web.zoom.us/j/4549344495?pwd=GbKcoccSWx39F3e8QF7PsAkCM3bvK6.1>

Meeting ID: 454 934 4495

Passcode: Aela2019.

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për Kompaninë "Pin Group Arch" Sh.p.k. Gjurgjevik i Vogël, Klinë, për impiantin fotovoltaik me kapacitet 2MW në Klinë dhe Zllakuqan.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin [vnm.komente@rks-gov.net](mailto:vnm.komente@rks-gov.net)

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.

**Lume's Details**  
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 687 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

### >> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Pirro Caka nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit "Hjadar Dushi" Gjakovë.

Shqipe Xharra nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m.m. "Hysni Zajmi" Gjakovë.

Vlera Deva nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e kl. 10.11.12. të Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanë me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira në qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.





## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales





**MEKA**  
HALAL FOOD

# TRADITË QË NGA

# 1992

